

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7720 E diel 25 Nëntor 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Dje në "European Interest"

Shqipëria është një vend që prej shumë vitesh aspiron të jetë pjesë e Bashkimit Europian. Një vend i vogël në Ballkan ...

Vijon në faqen 21

Nga MONIKA KRYEMADHI

Shqipëria drejt BE-së, një rrugëtim i shpresës dhe i sfidave



Opinion i Ditës

Duke pasur parasysh peshën specifike të Shqipërisë në politikën evropiane dhe më gjerë, zyrtarët rezidentë diplomatikë të vendeve të huaja ...

Vijon në faqen 22

Nga BEN ANDONI

Pse Rama dhe Basha janë "të ashpër" me ndërkombëtarët



Historia e konfliktit me bandën e Aldo Bares

Atentat biznesmenit në Lushnjë, në vitin 2005 i vranë vëllain se nuk pagoi "gjobën"

Plumba në lokal, plagoset Saimir Taullau. RENA "mësyn" në Lushnjë, mister autorët

Saimir Taullau është plagosur mbrëmë gjatë një sulmi me armë zjarri ndaj lokalit të tij. Mësohet se persona ende të paidentifikuar kanë qëlluar me breshëri automatiku ndaj objektivit të tyre dhe më pas janë larguar me shpejtësi, me motor. Burime zyrtare nga policia e Lushnjës bënë me dije se ngjarja ku mbeti i plagosur biznesmeni 47-vjeçar ...

Në faqen 10

DOSJA/ PROTESTA, INA NUKA: DOJA TA LARGOJA KAPSOLLEN, NDJEVA DJEGIE NE QAFE

POLICJA QE HUMBI GISHTAT: SI NDODHI PLAGOSJA IME

Prokuroria zbardh dinamikën e ngjarjes, ku u plagosën 15 policë e protestues. 18-vjeçari nën arrest: Nuk doja të lëndoja njeri, hodha gjithsej 3 shashka



(Në foto) Policia e plagosur, Ina Nuka, duke u nisur për kurim në Turqi



Në faqen 2-3

PROTESTA

Basha: Tërhiq nga "Unaza e Re". Rama: Burg, kush i hedh kapsolla policisë

Në faqen 4-5

KREU I ALUIZNI

Artan Lame: Ja si do veprohet me ndërtimet tek Unaza e Re

Në faqen 6

BANKA QENDRORE

Rama propozon Ridvan Boden për Këshillin e BSH, PD: Bën diversion

Në faqen 7

DHIMBJA E NENES

Djalin ia vrau policia greke, e ëma: E prita boll, nuk e deshi jetën

Në faqen 9

KOMPENSIMI



180 pronarët në Tiranë dhe në rrethe që ndajnë 210 milionë lekë

Në faqen 11

MUSO Historia e Parashqevi Qiriazit, sekretares së Komitetit të Manastirit

Si u mor "Himni i Alfabetit" nga kolegji i Yale

Në brendësi: Poezia e Ajncingerit nga Arjan Leka, Rexhep Ferri, Lazër Stani

NGA DAVID HOSAFLOOK

Kongresi i Manastirit (14-22 nëntor 1908) ishte ndër kuvendet më të rëndësishme në të gjithë historinë politike dhe kulturore të kombit shqiptar. Çështja kryesore ishte njësimi përfundimtar i alfabetit shqip.



i cili që i domosdoshëm për bashkimin e kombit. Kur flitet për këtë kongres, emri i Parashqevi Qiriazit duhet të nderohet po aq sa edhe burrat e komitetit. Si përfaqësuese e Shkollës së Vashave të Korçës, ajo ishte e vetmja delegate femër në Kongres ...

Suplement

PROTESTA PARA KUVENDIT DOSJA E PROKURORISE

Zbardhet dinamika e përplasjes së fortë, emrat e përfshirë në të dy krahet

Protesta, prokuroria: Burg për 6 nga 11 të arrestuarit

"Ja si u goditën policët para parlamentit"

TIRANË

Prokuroria e Tiranës ka zbardhur dinamikën e protestës që zhvillohet në enjten banorët e zonës së "Astirit" përpara Kuvendit, ku mbetën të plagosur 15 punonjës policie si dhe 3 banorë. Ndërkohë që u arrestuan 12 persona, mes të cilëve dhe 18-vjeçari Daniel Dobra, i cili akuzohet për plagosjen e rëndë me dashje të efektives 24-vjeçare, Ina Nuka. Mësohet se sot, organi i akuzës do të kërkojë masën e sigurisë "Arrest me burg" ndaj 6 personave të arrestuar. Bëhet fjalë për shtetasit: Fluturim Goleci, Amarildo Sinanaj, Dorjan Protoduari, Ruzhdi Daci, Marsel Velillari si dhe Stpati Bilbilaj. Lidhur me këta persona, prokuroria e kryeqytetit ka vlerësuar si të ligjshëm arrestimin e tyre, bazuar në provat e siguruar nga pamjet filmike. Ata akuzohen për veprat penale "Plagosje të rëndë me dashje", "Mbajtje të lëndëve shpërthyeshe", "Kundërshtim të forcave të policisë", "Organizim dhe pjesëmarrje në grumbullime dhe manifestime të paligjshme" si dhe "Prishje të qetësisë publike". Ndërsa, për 18-vjeçarin Dobra, masa e sigurisë pritet të jepet të hënën, megjë ai u prangos dy ditë më parë.

Ndërkaq, organi i akuzës do të kërkojë gjykatës masën e sigurisë "Detyrim paraqitje" për 5 protestues, konkretisht: Erald Muçaj, Ali Nalic, Lulzim Dozhdani, Alban Ahmetcenaj, Xhavit Gjata si edhe Lulzim Dozhdani. Pak ditë pas protestës, Prokuroria e Tiranës referuar të dhënave të mjeko-ligjorëve sqaron zyrtarisht rrethanat e plagosjes së efektives Ina Nuka dhe dëmtimeve që ajo ka pësuar. Sipas organit të akuzës, 24-vjeçarja, e cila është dërguar për mjekim në të specializuar në Turqi, ka pësuar dëmtime në pjesën e qafës nga ana e djathtë e saj, dëmtime në gishtin tregues dhe gishtin e mesit të dorës së majtë, si dhe dëmtime masive të dorës së



djathtë me apumtim të rësor të gishtit të madh.

DOSJA E PROKURORISË

Më datën 22.11.2018, rreth orës 10:30, në rrugën "Xhorxh Bush" dhe pikërisht para parlamentit, një numër i konsiderueshëm personash po zhvillonin një protestë kundër vendimit për prishjen e shtëpive në zonën e Unazës së Re, Tiranë. Gjatë zhvillimit të protestës disa persona kanë hedhur kapsolla, shishe plastike uji si dhe shkopinj druri kundrejt punonjësve të policisë, të cilët të planizuar me shërbim në hyrje të parlamentit ku disa nga këta punonjës janë dëmtuar.

Nga ana e oficerëve të policisë gjyqësore është bërë procesverbali i këqyrjes së vendit të ngjarjes. Vendi i ngjarjes është hyrja kryesore e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë në afërsi të sheshit "Fan Noli" Tiranë. Gjatë këqyrjes së vendit të ngjarjes në sipërfaqen e shtruar me beton janë gjetur dhe sekuestruar në cilësinë e provës materiale 4 kapsolla me ngjyrë të kuqe të paplasur, 6 kapsolla me ngjyrë të kuqe dhe të zezë të plasura, 12 bidonë me mbishkrime të subjekteve që i tregojnë, 1 kapak stilograf ngjyrë blu, tabela me mbishkrime, dy shkopinj druri, dy copa perde me

mbishkrime. Është bërë vendimi i ekspertimit daktiloskopik vlerësues të shisheve plastike, objekteve ekspertimi si dhe është bërë vendimi i ekspertimit kimik të katër kapsollave të paplasura. Në lidhje me këtë ngjarje është marrë deklarim që tregon rrethanat hetimi punonjësve të policisë, të dëmtuarës Ina Nuka, e cila është punonjëse e reparit "Shqiponja" Tiranë.

DOSJA E PLOTË E PROKURORISË

Është marrë kallëzim punonjësit të policisë së Komisarariatit të Policisë nr. 1, Tiranë, shtetasit Agim Troci, i cili ka qenë i planizuar me shërbim në hyrje të parlamentit, në anën e Rrugës së Elbasanit dhe pasi ai ka parë se protestuesit kanë përparuar të hyjnë në parlament, ka shkuar në ndihmë të kordonit të policisë, ku ai ka parë që një person i gjatë 175 cm me flokë gjysmë biond, me xhup të kuq me blu, me bluzë blu, me tuta sportive ngjyrë gri e ka goditur me grushte në fytyrë dhe pasi kanë ndërhyrë shërbimit e tjera për ta ndare, ai ka tentuar përsëri ta godasë atë me shkelma. Pasi është bërë i mundur shoqërimi në komisarariat, ky person quhej Fluturim Rexhep Goleci, i datëlindjes 20.05.1988, lindur në Dibër dhe banues në Paskuqan.


MESAZHI I METES

Presidenti i Republikës, Ilir Meta dënoi aktet e dhunshme përballë parlamentit. Ai u bëri thirrje palëve të përfshira që të shmangin përplasjet dhe të vendosin sa më parë një dialog institucional, në mënyrë që ankesave të banorëve që do t'u prishen shtëpitë tek Unaza e Re, t'i jepet një zgjidhje.

Punonjës të Policisë së Shtetit janë pyetur nga oficerët e policisë gjyqësore. Ata kanë deklaruar për dhunë fizike të ushtruar ndaj tyre nga persona që merrnin pjesë në protestë, persona të identifikuar deri në këtë fazë të hetimeve, si dhe persona të tjerë për të cilët po hetohet për identifikimin e tyre.

Është përpiluar raport shërbimi nga punonjësit e Komisarariatit Nr. 1 Tiranë, të cilët ishin të vendosur në shërbim, në lidhje me protestën dhe gjatë shërbimit ata kanë evidencuar disa persona që kanë bërë veprime të dhunshme si duke gjuajtur punonjësit e policisë me shashka, flakadanë, si dhe sende të forta, të cilët janë shoqëruar në komisarariat me emrat Alban Qemal Ahmetcenaj, Paolo Ajat Ahmetcenaj, Fluturim Rexhep Golemi si dhe janë evidencuar shtetasit Dorjan Protoduari dhe Luan Metalia. Deri në këtë fazë të hetimit rezultoi se shtetasit e mësipërm kanë goditur me kapsolla dhe sende të forta në drejtim të punonjësve të policisë.

Është përpiluar raport shërbimi nga punonjësit e policisë të seksionit të forcës së posaçme, "Shqiponja", të cilët pasi kanë marrë njoftim në lidhje me dy persona që dyshohen se kanë hedhur kap-



Protesta e banorëve të Unazës së Re përpara parlamentit

TË ARRESTUARIT NË FLAGRANCË

1. Alban Ahmetcenaj
2. Paolo Ahmetcenaj
3. Lulzim Dozhdani
4. Fluturim Goleci
5. Ruzhdi Daci
6. Marsel Velillari
7. Dorjan Protoduari
8. Amarildo Sinanaj
9. Stpati Bilbilaj
10. Ali Nalic
11. Erald Muçaj

Akuzat: "Goditje për shkak të detyrës", "Kundërshtim i punonjësit të rendit publik", "Organizim dhe pjesëmarrje në grumbullim dhe manifestim në mënyrë të paligjshme", "Prishje e rendit dhe qetësisë publike të kryer në bashkëpunim", parashikuar nga nenet 262,236/2,237 dhe 274 të Kodit Penal.

solla pasi ishin pjesëmarrës në protestë që do zhvillohej në hyrje të parlamentit, të cilët ishin Alban Ahmetcenaj i datëlindjes 30.09.1980, të cilët gjatë kontrollit ju gjetën një kapsollë piroteknike me ngjyrë të kuqe me mbishkrimin "Enigma Fire Works", ku 20 (njëzet) copë janë gjetur në xhepat e tij të xhupit dhe 20 (njëzet) copë janë në një kuti të pahapur, të cilën e mbante në një çantë shpine. Në lidhje me këtë raport shërbimi është bërë edhe kapja në flagrancë e tyre.

Është përpiluar një raport shërbimi nga punonjësit të policisë së Komisarariatit Nr. 4, Tiranë, të cilët janë planizuar me shërbim në afërsi të parlamentit, ku gjatë zhvillimit të protestës, ata kanë parë që

protestuesit kanë filluar të kryenin veprime të dhunshme ndaj punonjësve të policisë, duke qëlluar në drejtim të punonjësve me uniforme me sende të forta dhe fishekzjarrë.

Nga ana e tyre janë evidencuar dy persona, të cilët ishin në radhë e para të protestuesve, të cilët ushtronin dhunë ndaj punonjësve të policisë, të cilët janë shtetasit Amarildo Bexhet Sinanaj dhe Stpati Hyso Bilbilaj. Në lidhje me këta shtetas është bërë edhe video me pamje filmike nëpërmjet celularëve. Nga ana e punonjësve është bërë edhe këqyrja e pamjeve filmike, ku në këtë pamje shikohet një person i veshur me një bluzë sportive me ngjyrë të zezë dhe me një çantë krahu me pak mjekër; është me flokë të zeza, me vetulla normale, fytyrë rrumbullakët, i cili ndodhet në mesin e turmës dhe ndez një kapsollë dhe e hedh në drejtim të punonjësve të



← policisë. Gjithashtu, shikohet një femër e veshur me xhup të hollë me ngjyrë gri me flokë të verdha, të kapura sipër me një kasë e cila shikohet në fillim të turmës së protestuesve dhe fillon të dhunojë punonjësit e policisë. Gjithashtu, shikohet një person në mesin e protestuesve, i cili është i veshur me një xhup me ngjyrë të zezë sportive dhe mban në duar një pankartë. Ky shtetas është me flokë ngjyrë gështenjë, me mjekër, i parruar, i cili fillon të gjuajë në drejtim të punonjësve të policisë me pankartën që mbante në dorë si dhe me një dërrasë që e merr në tokë. Po në këtë pamje shikohet edhe një person tjetër, i cili ndez një kapsollë dhe e hedh në drejtim të punonjësve të policisë.

Është përpiluar një raport shërbimi nga punonjësit të policisë së Komisarariatit Nr. 3 Tiranë, të cilët janë planizuar me shërbim në afërsi të Kuvendit, ku gjatë zhvillimit të protestës ata kanë parë që protestuesit kanë filluar të kryenin veprime të dhunshme ndaj punonjësve të policisë duke qëlluar në drejtim të punonjësve me uniformë me sende të forta dhe fishekzjarrë. Nga ana e tyre, janë evidentuar shtetasit Rruzhdi Dukagjiri Daci, Fejzi Mino, Marsel Velillari Gezim Sadikaj. Në lidhje me këta shtetas është bërë edhe video me pamje filmike nëpërm-

jet celularëve, ku më pas është bërë edhe këqyrja e pamjeve filmike, të cilat janë hedhur në DVD, ku ka rezultuar se në orën 01:32 të datës 22.11.2018 kanë identifikuar shtetasit Gezim Sadikaj, i cili është i vendosur në rreshtin e parë përballë parlamentit, duke ushtruar dhunë dhe konfrontohet me punonjësit e policisë dhe me drejtorin e Policisë Tiranë, z.Kastriot Skënderaj si dhe vihet re se persona të paidentifikuar kanë hedhur kapsolla, tymuese si dhe sende të forta duke rrezikuar rëndë shëndetin e punonjësve të policisë.

Janë përpiluar disa raporte shërbimi nga punonjësit të policisë së Komisarariatit Nr. 1, Tiranë, të cilët janë planizuar me shërbim në afërsi të parlamentit, ku gjatë zhvillimit të protestës ata kanë identifikuar shtetasit Sali Lusha, disa deputet të opozitës si Salianji, Boçi, Balili, Gjyshaj dhe Vasilii.

Është përpiluar një raport shërbimi nga Seksioni i Operacioneve Speciale, të cilët kanë bërë foto dhe filmime në lidhje me protestuesit, ku ndër të tjera kanë konstatuar një shtetas të seksit mashkull, i moshës 35 vjeç, trup të shëndoshë, me flokë të rena, i gjatë rreth 180 cm, i veshur me xhup të zi, i cili kundërshton të punonjësit e policisë si dhe ka hedhur sende të ndryshme si kapsolla tymuese etj., i cili pasi është shoqëruar, është

Protesta/ Daniel Dobra në polici: Ndeza 3 kapsolla, i hodha te llamarinat

Ina Nuka: Ndjeva djegie në qafë. 18-vjeçari: S'doja të plagosja njeri

Dëshmia në prokurori/ Policia që humbi gishtin e madh: E largova kapsollën me dorë nga trupi

Autori i plagosjes me kapsollë të efektives së policisë Ina Nuka, në protestën para Kuvendit, ka dëshmuar përpara hetuesve. Daniel Dobra, 18 vjeç ka pranuar se ka qëlluar me kapsolle, por se nuk ka pasur për qëllim të qëllonte Policinë e Shtetit. Ai tha se kishte marrë pjesë në protestën që u zhvillua dy ditë më parë të Kuvendit, ndërsa pohoi se nuk kishte përdorur sende të kundraligjshme. "Jam banor i 'Astirit', në një banesë private, e cila është ndërtuar në vitin 2004 kur unë kam qenë 4 vjeç dhe jam rritur në atë banesë. Duke qenë se në derën e banesës sime është vendosur një shenjë me kryqë të kuqe, u jam bashkuar të gjithë personave, të cilët kanë protestuar për mënyrën e prishjes së banesës sime. Theksoj se nuk kam pasur dhe nuk kam përdorur sende të kundraligjshme gjatë protestës. Theksoj se kam pasur vetëm tre kapsolla, të cilat i kam ndezur dhe i kam hedhur në drejtim të llamarinave që rrethojnë namazgjanë që po ndërtohet", mësohet të ketë thënë ai mes të tjerave.

Ndërkohë, po dje u zbardh edhe dëshmia oficerës 24-vjeçare të policisë Ina Nuka, e cila mbeti e plagosur gjatë protestës së dhunshme përpara



Policia e plagosur, Ina Nuka

Kuvendit.

Mësohet se përpara prokurorëve, Nuka ka treguar atë se çfarë ndodhi, ku edhe dëmtoi rëndë gishtat e dorës së djathtë. Vajza është shprehur se ka qenë me shërbim në hyrje të parlamentit, në rreshtin e dytë. 24-vjeçarja thotë se në momentin e përplasjes në një moment ka ndjerë djegie në pjesën e qafës dhe njëkohësisht një erë tymi. Dhe menjëherë ajo ka vendosur dorën e djathtë në pjesën e qafës dhe në këtë moment ka dëgjuar një shpërthim dhe dhimbje në pjesën e qafës dhe në dorën e djathtë.

Nuka është shprehur se kapsolla ka ardhur përballë në drejtim të Komitetit Mysliman. Kujtojmë se ajo është dërguar në Stamboll për mjekim më të specializuar. "Ajo ka qenë me shërbim në hyrje të Kuvendit, në rreshtin e dytë dhe gjatë protestës, ajo ka parë që protestuesit kanë ardhur me pankarta në duar si dhe me bidonë plastike e kapsolla dhe ndërkohë që po zhvillohej kjo situatë, në një moment ajo ka ndjerë një djegie në pjesën e qafës nga ana e djathtë e saj dhe njëkohësisht një erë tymi dhe menjëherë ajo ka vendosur

dorën e djathtë në pjesën e qafës dhe në këtë moment ka dëgjuar një shpërthim dhe dhimbje në pjesën e qafës dhe në dorën e djathtë. E dëmtuara ka deklaruar se kapsolla ka ardhur përballë në drejtim të Komitetit Mysliman. Është bërë edhe këqyrja fizike e shtetasës Ina Nuka, ku konstatohet dëmtime në pjesën e qafës nga ana e djathtë e saj, dëmtime në gishtin tregues dhe gishtin e mesit të dorës së majtë, si dhe dëmtime masive të dorës së djathtë me apurim të rësor të gishtit të madh", thuhet në dosjen e prokurorisë.

identifikuar si shtetas Dorjan Protoduari. Në orën 11:12 kanë konstatuar një shtetas rreth moshës 20 vjeç, i gjatë rreth 180 cm, i veshur me xhup me ngjyrë të zezë, me kapuç, me bluze gri e errët, i cili bënte veprime dhune ndaj punonjësve të policisë. Në orën 11:25 është konstatuar një person i moshës 50 vjeç i veshur me xhup të zi me kapuç, i cili bënte veprime të dhunshme ndaj punonjësve të policisë, i cili pasi është shoqëruar, është identifikuar si shtetas Rruzhdi Daci. Rreth orës 11:30 janë konstatuar dy shtetas, Alban Ahmetcenaj dhe Paolo Ahmetcenaj, të

cilët qëllonin kordonin e policisë dhe hidhnin kapsolla dhe tymuese, ku njëri nga këta persona është i moshës 20 vjeç, i veshur me xhup të zi dhe me një çantë të zezë, me figura ngjyrë gri, ndërsa tjetri i moshës 30 vjeç, me mjekër, me xhup të zi.

Është përpiluar një raport shërbimi nga nd.spezialist pranë seksionit të krimeve ndaj pronës, ku thuhet se shtetas Ali Tahir Nalic, i datëlindjes 03.09.1983, lindur në Kukës dhe banues në Tiranë është parë duke kryer veprime të dhunshme duke tentuar të kalojë me forcë kordonin e punonjësve të policisë.

Nga ana jonë është bërë këqyrja e pamjeve filmike të nxjerra nga interneti në lidhje me protestën e datës 22.11.2018, ku shikohen pamjet filmike të protestuesve që godasin dhe hedhin kapsolla në drejtim të punonjësve të policisë, ku më pas janë dëmtuar punonjësit e policisë, Ina Nuka dhe Dhimitraq Ziu.

Është bërë këqyrja fizike dhe marrja e faktorëve plotësues të qitjes për shtetasit: Amarildo Sinanaj, Shpati Bilbilaj, Marsel Velillari, Lulzim Dozhllani, Erjona Dozhllani, Ali Nalic, Paolo Ahmetcenaj, Alban Ahmetcenaj, Dorjan Protodu-

ari, Rruzhdi Daci, Flurim Goleci, Ermir Goleci, Mari- gjen Braçaj, Adem Cara Bujar Gjata.

Është bërë vendimi i ekspertimit mjeko-ligjor për punonjësit e policisë, I. Nuka, K.Muçollit, A.Asllanaj, K.Bala, Q.Brahimi, F.Kopani, H.Polici, G.Sula, R.Murataj, E.Asllanaj, L.Osmani, M.Luli është bërë vendimi i ekspertimit kimik në lidhje kapsollat e gjetur në vendin e ngjarjes si dhe kapsollat sekuestruar shtetasve Alban dhe Paolo Ahmetcenaj. Është bërë vendimi i ekspertimit kimik për faktororë plotësues të qitjes.



SHPALLJE ANKANDI

Zyra Permbarrimore "E.G Bailiff Service" me përmbarrues Enuar Merko me adresë Rr Ibrahim Rruova, Pall 64, Hyrja 8, Ap 1, Tiranë, njofton se me date 14.12.2018 ora 8⁰⁰ - 16⁰⁰ në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankandi i Il-te për shitenj e pasurisë të paluajtshme, Apartament me Nr.pasurisë/6/143+1-38 me adresë "Lagja 16 Prilli", me sipërfaqe totale 120 m², Zona Kadastrale Nr.8534, Vll.8, Fa.161. Fier në pronësi të Z.Mihal Jorgo Gjukuria me vlerë fillestare në ankand 30.240 (Tridhjet mijë e dyqind e dyzet) EURO. Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, +355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com



SHPALLJE ANKANDI

Zyra Permbarrimore "E.G Bailiff Service" me përmbarrues Enuar Merko me adresë Rr Ibrahim Rruova, Pall 64, Hyrja 8, Ap 1, Tiranë, njofton se me date 14.12.2018 ora 8⁰⁰ - 16⁰⁰ në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankandi i I-re për shitenj e pasurisë të paluajtshme, Arë me sipërfaqe 1500 m², nr. 179/87, vol. 8, fq. 19 z.k. 2326, në Kuman, Fier në pronësi të Z.Arben Refat Ramizi me vlerë fillestare në ankand 600.000 (Gjashëqind mijë) Lekë. Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, +355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com



SHPALLJE ANKANDI

Zyra Permbarrimore "E.G Bailiff Service" me përmbarrues Enuar Merko me adresë Rr Ibrahim Rruova, Pall 64, Hyrja 8, Ap 1, Tiranë, njofton se me date 14.12.2018 ora 8⁰⁰ - 16⁰⁰ në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankandi i I-re për shitenj e pasurisë të paluajtshme, Trull me sipërfaqe 1000 m² ndodhur në ZK. 2399, Nr. 281/20, Vol. 13, fq. 9 nga kjo Ndërtëse me sipërfaqe 134 m² në pronësi të Z.Illir Alush Uku me vlerë fillestare në ankand 8.000.000 (Tetë milion) lekë. Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, +355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com

UNAZA E MADHE PROTESTA

Protesta sot para gjykatës, Vilsoni i vogël: Më liro babin nga burgu, kam ditëlindjen

Basha, Ramës: Tërhiqni nga Unaza e Re, hajdut i çmendur

"Bëji hesapet mirë kur u sul policinë banorëve"

Valentina Madani

Banorët e zonës së "Astirit", të cilët preken nga projekti i Unazës së Madhe protestuan sërish dhe mbrojtje të banesave të tyre. Nën thirrjet "Nuk lëshojmë shtëpitë tona" dhe "Poshtë qeveria", banorët e zonës së "Astirit" kanë bllokuar sërish rrugën në shenjë proteste. Banorët e "Astirit" fuan të gjithë qytetarët shqiptarë që t'i bashkohen protestës së tyre sot në orën 11:00 para Gjykatës së Krimeve të Rënda, ku do të jepet vendimi për protestuesit e arrestuar. Prokuroria ka kërkuar dënimin me burg për 5 nga protestuesit e arrestuar. Banorët e Unazës së Re e quajtën gjenocid atë që Rama dhe qeveria e tij po bën ndaj tyre dhe e krahasuan me atë të diktatorit të zi, Adolf Hitler. Sipas protestuesve, këtë që po u bën Rama atyre nuk e bënë as nazistët gjatë pushtimit. Banorët deklaruan se do t'i qëndrojnë deri në fund kauzës së tyre. Mbrojtja e pronës dhe e shtëpisë nuk është çështje vetëm e të rriturve, por edhe e fëmijëve në zonën e "Astirit". Vilsoni i vogël, i përlotur i kërkoi kryeministrit Rama që të mos u prishtë shtëpitë dhe t'i lironë babain që ka në burg, pasi nuk janë ata e keqja e vendit, por kriminelët. "Ai ka futur babin tim në burg, ai kryeministri. Do doja që babi im të vinte në 28 nëntor, sepse unë kam ditëlindjen", tha Vilsoni.

MBËSHETJJA

Në mbështetje të protestuesve shkuan kreu i opozitës, Lulzim Basha; deputetë të PD dhe LSI. Kreu i PD-së akuzoi se kjo që po bën Rama është barbari ndaj qytetarëve. Z.Basha i bëri thirrje Ramës që të mos përdorë policinë kundër qytetarëve, ndërsa tha se dhuna në komisarjat është e filmuar dhe secili do të mbajë përgjegjësi. "Ajo që po ndodh është një barbari, një shkelle barbare e Kushtetutës, e ligjeve që mbrojnë banesat, e ligjeve që garantojnë transparencën. Dua t'i bëj një thirrje Ramës dhe qeveritarëve, t'i



Kreu i PD-së, Lulzim Basha, dhe një protestë

"Rama, i zhytur në batakun e kriminalitetit"

Kryemadhi: Kryeministri po u heq shqiptarëve të drejtën e pronës

Kryetarja e LSI, Monika Kryemadhi akuzoi dhe kryeministrit Edi Rama se po u heq shqiptarëve edhe të drejtën e pronës. Në një postim në "Facebook", Kryemadhi duke u ndalur te protesta e banorëve të Unazës së Re, shprehet se Rama përmes kërcënimeve dhe gjuhës vulgare po përpiqet të ndalë qytetarët që të kërkojnë të drejtën e tyre. "Edi Rama dhe veglat e tij po mundohen t'u heqin shqiptarëve edhe një nga pak të drejtat që u kanë mbetur, të drejtën e protestës. Me kërcënime,



keqpërdorimin e policisë, me gjuhën vulgare me të cilën u drejtohet banorëve të Unazës së Re, ai më kot përpiqet t'i ndalë qytetarët të kërkojnë të drejtën e tyre. I zhytur në batakun e kriminalitetit,

bëjnë mirë hesapet kur vërsulin policinë kundër qytetarëve. Dhuna që kanë ushtruar në komisarjat kundër banorëve është e regjistruar dhe secili do të mbajë përgjegjësi. Po të kishim prokurori, do të kishte nisur hetimi. Rruga e vetme është ajo e përballjes popullore", theksoi Z.Basha. Më herët nga selia e PD-së, lideri i opozitës paralajmëroi dhe me tone të ashpra kryeministrit Rama t'i japë fund projektit për ndërtimin e Unazës së Re. Sipas Bashës, kryeministri është i gatshëm të bëjë dëshmor me zor efektiven e

policisë apo të flakë jashtë shtëpisë fëmijë të pafajshëm. "Sot dua të të jap një mesazh të qartë e të prerë: tërhiqni nga afera korruptive e Unazës. Asnjë centimetër nuk do të përparosh në këtë aferë. Çdo centimetër u kushton shqiptarëve 2 mijë euro. Të gjithë atje janë e do të jenë për të të penguar ty", u shpreh kreu i opozitës. Basha përsëriti sërish akuzën për menaxhimin e protestës nga ana e policisë. "Në qoftë se do të kishim një polici të trajnuar, në radhë të parë nuk duhet të kishte police, zonja, va-

REAGIMI

Do të të pëlqente ta bëje dëshmore me zor o plehër, efektiven e policisë! Ti mezi po pret o i sëmurë. Po kështu e mbajte mandatin e parë, i bëre kriminelët deputetë dhe biznesmenë, dhe tani do t'i bësh policet vajza, dëshmore për karrigen dhe tepsinë tënde, o i çmendur, o hajdut!", u shpreh kryetari i PD-së.



Gjatë protestës së banorëve të Unazës së Madhe

THIRRJA

Banorët e Unazës së Re, shtëpitë e të cilëve preken nga ndërtimi i Unazës së Madhe dolën sërish dhe në protestë. Nën thirrjet "Nuk lëshojmë shtëpitë tona" dhe "Poshtë qeveria", banorët e zonës së "Astirit" kanë bllokuar sërish rrugën në shenjë proteste.

Protesta, deputetja e LSI: Po shfaqet luftë civile

Në protestën e banorëve të Unazës së Re dhe morën pjesë edhe deputetë të LSI-së, të cilët mbështetën protestuesit, që prej 21 ditësh dalin në rrugë për të kundërshtuar shembjen e banesave të tyre. Deputetja e LSI-së, Nora Malaj, i kërkoi qeverisë të dëgjojë dhe të shikojë gratë që kanë dalë në protestë, sepse ato e lëkundin dhe shtetin. Ajo bëri thirrje për zgjidhjen e problemeve të qytetarëve. Sipas saj, sot vendi është kthyer si lëndina e lotëve, ku qau vajza ku vrau gishtat, ku qan nëna e një djali që i hyri në burg, kur qau djalin që kërkon ndihmë për të jetuar dhe tek ne sot po shfaqet një luftë civile. "Ndaj, të bëhemi të gjithë bashkë për t'i dhënë fund kauzës së mashtimit dhe për t'i dhënë zgjidhje problemit. Me zgjidhjen e problemit ne bëjmë atë që nuk quhet më qeveri e kimit, por qeveri e qytetarëve dhe për qytetarët. Po, ne jemi sot këtu dhe jemi njëzëri fuqishëm, se jemi me duar të pastra, jemi me shpirt të pastër dhe jemi për çdo njeri, për çdo qytetar dhe për çdo familjar të Republikës së Shqipërisë", tha deputetja e LSI-së.



firmëzuesi i shkatërrimit të Shqipërisë, çdo ditë shpik beteja dhe heronj imagjinarë, me synimin e vetëm që të tërheqë vëmendjen nga protesta, e cila çdo ditë e më shumë gërryen themelet e pushtetit të kimit dhe oligarkëve. Fryma e rebelimit popullor është frika më e madhe e diktatorëve dhe si e tillë, ajo e tmerron Edi Ramën, që prej muajsh vetëm menaxhon krizat e deputetëve të tij të inkriminuar dhe të klientëve të tij, që pasurohen me paratë e shqiptarëve", tha zj.Kryemadhi.

jza të pambrojtura. Po kështu e mbajte mandatin e parë, i bëre kriminelët deputetë dhe biznesmenë dhe tani do t'i bësh policet vajza, dëshmore për karrigen dhe tepsinë tënde, o i çmendur, o hajdut!", theksoi z.Basha. Lideri i opozitës akuzoi kryeministrit se po përdor forcat e policisë për interesat e tij personale. "I përdor në propagandën e tij dhe pastaj do t'i bëjë edhe dëshmore me zor. Do të pëlqente ta bëje dëshmore me zor o plehër, efektiven e policisë!", u shpreh kreu i opozitës.



Kryeministri: Së shpejti, në parlament një ligj për forcat superspeciale

Rama: Gjymtimi i Inës prej dhunës, mund të ishte dëshmorja e parë

"Burg për ata që hedhin kapsollat drejt policisë"

Kryeministri Edi Rama i kujtoi dhe opozitës dhe protestuesve të zonës së "Astirit" se do të përballen me ligjin për hedhjen e kapsollave kundrejt punonjësve të policisë. Deklarata u bë gjatë prezantimit të flotës së makinave të reja të Policisë së Shtetit, e cila është pajisur me 134 automjete dhe 30 motorë të rinj. Kreu i ekzekutivit dënoi dhunën ndaj efektivëve Ina Muka, duke kujtuar që nëse nuk do të kishte reaguar në momentin e duhur, sot do të ishte mes dëshmorëve të policisë. Kryeministri Edi Rama iu përgjigj akuzave të opozitës në lidhje me profesionalizmin e polices Ina Nuka, që u qëllua me kapsollë në proteste duke pësuar dëmtime serioze në gishtat e dorës. Rama pohoi se efektivja 24-vjeçare mund të kishte humbur jetën dhe të bëhej dëshmore në protestën para Kuvendit, nëse nuk do të kishte reaguar shpejt. "Një efektive e Policisë së Shtetit mund të kishte humbur jetën 48 orë më parë. U tha nga ata që janë shkaktarë të nxitjes së dhunës se humbi gishtat sepse nuk ishte e trajnuar për përdorimin e lendeve plasëse, që Kodi Penal e dënon si krim të rëndë. Ajo vajza dhe shumë të rinj të tjerë, jo vetëm që janë të trajnuar, por stërviten fizikisht çdo ditë. Sot do të kishim një tjetër dëshmore dhe mesa di, të parën dëshmore të Policisë së Shtetit. Ishte shpejtësia e reagimit të saj, që bëri të humbte vetëm gishtat e njërës dorë. Ajo vazhë i përket gjenarës së të reja dhe të rinjve të shkolluar në Akademinë e riçelur të Sigurisë. Akademia që u mbyll për vite të tëra, duke ndërprerë një cikël trajnimesh të pazëvendësueshëm për Policinë e Shtetit", shprehet kryeministri. Deklaratën në përgjigje të qëndrimeve të fundit të Bashës dhe eksponentëve të tjerë të PD-së në lidhje me profesionalizmin e pakët të polices Ina Nuka, kreu i qeverisë i bëri gjatë një aktivitetin në sheshin "Nënë Tereza" për shtimin e flotës së policisë me mbi 143 mjete të reja. Kryeministri gjithashtu lajmëroi që së shpejti në parlament do të ketë një nisim të re për krijimin e njësisë speciale në mbrojtje të rendit dhe kundër të fortëve, ndërsa theksoi se po diskutohet edhe mundësia e krijimit të xhandarmërisë. "Kemi nevojë për një reagim intensiv të



DEKLARATA
"Humbi gishtat, sepse nuk ishte e trajnuar", - u tha nga ata, të cilët kanë përgjegjësi të drejtpërdrejtë për nxitjen e dhunës dhe për goditjen me lëndë plasëse, të cilën Kodi Penal e dënon si krim të rëndë. Ishte gatishmëria e reagimit që i shpëtoi asaj jetën, sepse sot do të kishim, - lavdi Zotit, kjo nuk ndodhi! - një tjetër dëshmore dhe me sa di, e parën dëshmore vajzë e Policisë së Shtetit", tha z.Rama.

Paketë sociale për banorët e Unazës së Re

Veliaj ironizon opozitën: Pres fitore të sigurt, pa kapsolla

Erion Veliaj nuk ka asnjë mëdyshje për vijimin e projektit të Unazës së Re, por as për mënyrën e mbështetjes financiare të banorëve që preken nga projekti. Gjatë forumit rinor eurosocialist të Tiranës, Veliaj tha se për banorët do të ofrohet paketë sociale, bonus qiraje, shtëpi sociale ose kredi të buta. "Partia Socialiste është e vetmja që të gjitha këto ndërhyrje i bën me një paketë sociale dhe në rastin e Unazës së Re është shumë inkurajuese që të gjithë banorët, banorët e vërtetë e jo mingashët, jo ata që vijnë me autobusë tek lodrat, që vijnë me autobus e gjithë Bashkia Kamëz. Shtatë familjet e para do t'i falënderoj për besimin që i kanë dhënë Bashkisë së Tiranës. Gjysma e familjeve do të trajtohen nga ARRSH-ja me pagesën në dorë për çfarë vlen prona e tyre dhe gjysma tjetër nga Bashkia e Tiranës si këta shtatë të parët. Të hënën përgatitemi të presim pjesën tjetër dhe t'u japim një ofertë ose qira, ose një shtëpi sociale. Unë besoj që kemi treguar që jemi e vetmja parti që jo vetëm e ndërton qytetin dhe shtetin, por ka sot paketën sociale më bujare ndonjëherë për kushtet e Shqipërisë, në historinë e Shqipërisë", u shpreh kreu i Bashkisë së Tiranës. Veliaj kishte edhe një mesazh për opozitën, që sipas tij po përpiqet të pengojë zhvillimin e qytetit. "Shumica e popullit mund të jetë e heshtur, mund të mos jetë një minorancë e zhurmshme, por është aq i madh kori i njerëzve që duan që vendi të ecë përpara, që duan që vendi të zhvillohet. Ne mund të fitojmë pa asnjë kapsollë, Partia Socialiste mund të fitojë vetëm duke qenë një parti që punon, duke respektuar kundërshtarin, duke u sjellë me etikë, duke i thënë komunitetit alternativa, duke i bashkuar dhe jo duke i përçarë njerëzit dhe forca më e madhe që është investuar në bashki, që është investuar në paqim të popullsisë, që është investuar tek puna dhe rezultatet konkrete, është kjo ku jemi sot, familja jonë, Partia Socialiste e Shqipërisë", tha z.Veliaj.

REAGIMI

Pas deklaratave të z. Rama për dhunimin e Ina Nukës, reagoi zëdhënësja e PD, Ina Zhupa, sipas së cilës kryeministri nuk e fsheh dot megavjedhjen 40 milionë euro, duke përdorur fatkeqësinë e Ina Nukës. Sipas Zhupës, Rama foli gjatë duke sharë policinë e djeshme falë, punës të së secilës nën drejtimin e Lulzim Bashës, në vitin 2010 bëri të mundur lëvizjen pa viza.

"Dhuna para Kuvendit, qytetarët të reflektojnë!"

Lleshaj: Verbëria politike ka potencial për të sjellë dëme

Ministri i Brendshëm, Sandër Lleshaj i kërkoi opozitës që të mbështesë policinë dhe jo të rreshtohet përkrah dhunësve të forcave të rendit. "Ato duar që u ngritën kundër Ina Nukës dhe kolegëve të saj, na tregojnë se verbëria politike e ka përherë potencialin për të sjellë dëme, jo vetëm mbi policinë, por mbi krejt shoqërinë. Izolimi i këtyre devijimeve të rrezikshme dhune kërkon jo vetëm reagim të vendosur të policisë, por edhe reflektim të gjerë shoqëror", deklaroi ministri Lleshaj. Ministri i Brendshëm, Sandër Lleshaj komentoi sërish protestën e dy ditëve më parë para parlamentit. Në fjalën përshëndel-



laroi ministri Lleshaj. Ministri i Brendshëm, Sandër Lleshaj komentoi sërish protestën e dy ditëve më parë para parlamentit. Në fjalën përshëndel-

të në prezantimin e flotës së re të Policisë së Shtetit, Lleshaj kërkoi reflektim nga qytetarët dhe politika. "Jo më larg se dy ditë më parë u përballën me një sulm të pabesë. Verbëria politike e ka përherë potencialin për të sjellë dëme. Ftoj qytetarët për një reflektim, te policia duhet të shohim forcën e mburojën tonë. Për reflektim ftoj edhe përfaqësues të caktuar politikë, që të rreshtohen krah policisë e jo përballë saj, për një të ardhme më të mirë europiane", u shpreh Lleshaj.

vazhdueshëm ndaj të fortëve. Me shpejtësi do të çojmë në parlament projektin e ri për krijimin e një force tjetër reagoni parandalues, një forcë të shpejtë reagimi parandalues, një force superspeciale, që do të merret në mënyrë të dedikuar me të gjithë ata që janë një bezi për komunitetet dhe që kanë precedentë penalë, apo që kanë profile kriminale,

mbi të cilët duhet të ushtrohet përditë presioni parandalues i Policisë së Shtetit. Nga ana tjetër, duhet të çojmë përpara dhe të finalizojmë diskutimin për xhandarmërinë, për të marrë një vendim përfundimtar, pas shumë e shumë debatesh të bëra dhe në të shkuarën, nëse po, apo nëse jo dhe për të futur në një proces historik, siç është ky i

kalimit nga një epokë shumë problematike në raport me sigurinë e me krimin, në një epokë kontrolli të plotë në fushën e sigurisë dhe zbrapsje të plotë krimin nëpër skutat e veta, edhe një numër të konsiderueshëm efektivësh nga Policia Ushtarake. Kjo është temë që meriton në debat shterues pa humbur kohë", u shpreh kreu i qeverisë.

LEGALIZIMET INTERVISTA

Historia e projektit të Unazës së Madhe, kreu i ALUIZNI-t: Daton shumë vite më parë

Unaza, Lame: "Kryqi" nuk tregon prishjen, 207 objekte skualifikohen

"Procesi i mbylljes së procedurave është në mes"

Kreu i ALUIZNI-t, Artan Lame foli dje në "News 24" për objektet që skualifikohen nga projektet e Unazës së Re. Pas 21 ditësh proteste të banorëve, Lame tha se ata nuk janë njoftuar akoma dhe se procesi i mbylljes së procedurave është në mes. Kreu i ALUIZNI-t tregoi në emisionin "Kjo Javë" pak nga historia e projektit të Unazës së Re. Lame shpjegoi se projektet e Unazës së Madhe daton shumë vite më parë.

Z.Lame, a do të ketë një fazë për njoftimin e banorëve të Unazës së Madhe?

Natyrisht, ARRSH pret çdo ditë në zyrë banorë që iu shpjegohet si është situata. Prandaj them që është një proces që s'ka mbaruar akoma. Nëse duam që projektet të avancojnë, pamët janë të bashkisë, ajo vendos nëse hiqen. Bashkia i ka mbjellë, bashkia i heq. Kryeqet nuk i kam vendosur unë, s'e kam idenë. Por besoj se janë shënuar objektet që në një mënyrë a një tjetër i prek projektet.

A mund të ketë objekte që do të kenë kryqe dhe nuk do prishen?

Po, patjetër. Sa objekte skualifikohen në planin për zgjerimin?

Qeveria nuk ka një letër dhe gërshërët e pret lekë. Ato lekë merren nga xhepi im dhe i yti. Ne blem dakord që po, meqenëse nuk duam fëmijë e gra në rrugë, po juaj japim këto para për strehim. Aktualisht janë 207, pra plus minus 3, se ka objekte të pabanuara. Nuk është bërë akoma skualifikimi. Jemi në fazën që rreshtohen objektet që preken. Paratë nuk jepen me skualifikimin dhe dëmshpërblimi nuk jepet me skualifikimin. Këtu është pjesa e politikës, kur duam t'i politizojmë gjërat dhe t'i stresojmë njerëzit, sidomos ata që kanë një hall është shumë e lehtë. Janë objekte që iu intereson projekti. U bë mirë me shqiponjën", si donte politika ta bënte mbikalimin, duke e lënë shqiponjën aty. Mund të ma thuash ti, si duhet të bëhet mbikalimi pa hequr shqiponjën? Sa e lehtë është të luash me ndjenjat e njerëzve.

Pas 3 viteve bonus çfarë ndodh?

Ai treshi nuk është gjetur me 'abra-kadabra', ka një logjikë të caktuar, që vjen pra për nga e shkuara. Deri në 2014-ën, edhe projektet e para fare të kësaj qeverie thoshin



Kreu i ALUIZNI-t, Artan Lame

HISTORIA

"Historia me këto toka fillon me planin rregullues të Tiranës që në 1945, flitej për Unazën e Madhe të qytetit. Ishte e definuar çdo vit. E realizuar po me planin e Adil Çarçanit vazhdoi edhe qeveria Mexi. Dhe ajo unazë u bë qoftë prej vizionit, qoftë për fluksin e makinave, apo për ndërtime", tha Z.Lame.

dil jashtë, e ke pa leje, shtëpia do priset. Në të gjitha projektet e bëra në këtë vend deri në vitin 2014 thuhej dil jashtë se shtëpia do priset. Nga 2014, pikërisht për shkak të ndeshmërisë së kësaj qeverie, u mendua nuk mund të nxjerrim njerëz në rrugë dhe u mendua koncepti i bonusit të qirasë. Përveç kësaj, edhe bashkia ka premtuar, edhe qeveria ka premtuar përfshirjen qoftë në kreditë afatgjata për banim, qoftë edhe strehimin social. Pra, nga hedhja në rrugë në trajtimin me bonus qeverie.

Ju thoni janë 207 objekte, sa janë me hipotekë?

Këtu do bëhet një rrugë, kopsht apo urë, do shpronësohen pronarët sipas pronës që kanë të regjistruar në

hipotekë. Pra, në rastin konkret çdo pronar që ka një pretendim për atë pronë duhet, ta regjistrojë atë pronë. Nuk shkohet tek ALUIZNI, por merret një certifikatë pronësie në hipotekë dhe bëhet regjistri i pronave. Objekte të regjistruara në hipotekë deri sot janë rreth 65 objekte, plus janë rreth 300 e ca parcela toke. Ajo ka qenë zonë përgjithësisht në krahun e brendshëm të Unazës, tokë me pronarë të vetëm dhe në krahun e jashtëm, tokë e ndarë me 7501". Ka një disproporcion me pronat, sepse janë të ndara në rripa-ripa dhe gjithsecili do marrë shpronësimin.

Kërkesa për legalizim bëhet fjalë për një familje apo

DËMSPËRBLIMI

"Aktualisht janë 207, pra plus minus 3 se ka objekte të pabanuara. Nuk është bërë akoma skualifikimi. Jemi në fazën që rreshtohen objektet që preken. Paratë nuk jepen me skualifikimin. Dhe dëmshpërblimi nuk jepet me skualifikimin", tha Z.Lame.

disa familje brenda një vile?

Nuk besoj se ka ndonjë që e diskuton se legalizimet i bëri kjo qeveri që është sot. Po të kishte bërë gjysmën e këtyre që kemi bërë në qeveria paraardhëse, do ishin mbyllur. Ne e kemi premtuar që brenda 2 viteve në vijim mbyllet procesi i legalizimeve. Dje ishim në Fier, për të mbyllur procesin e legalizimeve për të gjithë komunat e qarkut Fier. Ishin 8 mijë e ca legalizime të bëra në këtë periudhë. Nuk mund të na kërkohet llogari neve pse nuk e mbyllni procesin, kur në qeverisjen e kaluar ishin bërë 72 legalizime. Ky kapitull u mbyll.

Kur daton projekti i një Unazë të Madhe?

Historia me këto toka fillon me planin rregullues të Tiranës që në 1945-ën. Flitej për Unazën e Madhe të qytetit. Ishte e definuar çdo vit. E realizuar po me planin e Adil Çarçanit vazhdoi edhe qeveria "Mexi". Dhe ajo unazë u bë qoftë prej vizionit, qoftë për fluksin e makinave, apo për ndërtime. Të mos harrojmë që në qeverinë "Berisha", un-

aza është e gjerë 3 me 3, plus rrugë anësore. Vetë qeveria "Berisha", se ashtu duhej nga halli, e bëri të gjerë. Dëgjoj marrëzi në lidhje me gjerësinë. Rruga që do bëhet është më e gjerë se ky është fluksi i qytetit. Ka 3 kategori pronash: pronat shtet - cep i ngecur në buzë të përrroit të Lanës; pronat të ish-pronarëve - nga krahu i brendshëm i Unazës; pronat me ligjin 7501. Në këto 3 kategori ka vepruar zënia forcërisht e pronës. Shteti nuk ka vepruar në atë kohë. Kam dëgjuar qytetarë që thonë që "ia bleva njërit pa letra", ku? Do i besojmë fjalës, që do të thotë se ai nuk e kish të veten dhe më thanë po të erdhi njeri, më thuaj mua, po të erdhi shteti, dilli zot vetë. Vjen shteti, që një ditë që të thonë duhet të spostohesh.

Ka raste që ish-pronari ka truall aty a merr kompensim ish-pronari?

Ligji i legalizimeve, që nuk është bërë nga kjo qeveri, është shkruar nga Lulzim Basha dhe firmosur nga Berisha në 2006. Atë ligj po zbatojmë edhe ne. Ata e bënë ligjin dhe nuk e zbatuan, ne i premtuam dhe po i bëjmë. Ligji i legalizimeve parashikon për ish-pronarët po me një nen të Sali Berishës, ku ka truall me pronarë, që është zaptuar dhe aty po ndërtohen ndërtime të larta, legalizimi ndërpritet dhe duhet të futet në lojë dhe pronari i truallit. Pronari merr vetëm paratë e truallit. Edhe sikur të mos ishte ky zgjerim i Unazës, nuk mund të legalizoheshin ato ndërtime.

A kenë një përgjigje se si është e mundur se 100 pusesh objektesh e kanë të legalizuar ndërtesën, e cila është në një vijë urbane me të tjerat pa legalizuar, a ka diferencim?

Nuk është bërë asnjë diferencim, po mbroj dhe ato pak legalizime të bëra në qeverinë

paraardhëse. Nga pikëpamja formale juridike, sepse kanë legalizuar në shtratit e Unazës, sa e la Sandër Mexi. Legalizimet e kohës së tyre, ato pak që kanë bërë janë bërë me shtratit e Unazës së ngushtë, kështu që nga pikëpamja formale janë në rregull. 40 nga këto legalizime janë bërë në korrik-shtator 2013, pra edhe pasi kishin humbur zgjedhjet. Nuk dua të hyj pastaj se si ishin bërë ato legalizime. Këto i përmendi dhe kryeministri, përmendi dhe prokurorinë, sepse ne kemi gjetur legalizime dhe me vetë planin rregullues, pra me shtratit e ngushtë të Unazës.

Ka ankesa nga banorët se i janë kërkuar 30 mln për të legalizuar?

Ti mendon se për një shtëpi që vlen 20 mln janë kërkuar 30 mln. Po i marr të mirëqenë që janë të gjithë korruptuar, këta që e dinë që nuk mund të bëhen si mund të bëjnë legalizime. Nuk ka çfarë t'i kërkojë sikur dhe 300 mln të jetë i gatshëm t'i jap. Kjo shpjegon rastin se nuk mund të jetë nga punonjësit të brendshëm. Edhe sikur të ketë bërë vakti t'ia kenë thënë janë lloj-lloj sekserësh që vijnë vërdallë institucionit. Nuk bën vakti që të ndodhë kjo gjë. Përtej rasti të Unazës nuk po them se nuk ka raste mit marrje, por pra për përfitojë nga rasti t'u them qytetarëve mos u merrni me ata që iu thonë ta bëjnë unë me kaq apo me kaq. Merruni me institucionin, merruni me drejtorin. Tetori u mbyll me 3400 shtëpi të legalizuara. Ju shikoni çdo javë kryeministrin dhe bën mirë që del dhe nxjerr raste ku janë zvarritur qytetarët, por mos harroni se janë 100-300 apo 500 raste që iu legalizohen pa ju thënë njëherë plaç.

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND
ZYRA PERMBARIMORE GJYQESORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'

A. Pasuria nr. 26/ 319, e llojit 'truall', vol. 27, fq. 207, zk. 8642, sip. 10.000 m2, ndodhur në Sarandë, në pronësi të GRIGOR TAVO;
B. Pasuria nr. 26/ 320, e llojit 'truall', vol. 27, fq. 208, zk. 8642, sip. 10.000 m2, ndodhur në Sarandë, në pronësi të GRIGOR TAVO;
C. NIMI 49.754.880 LEKË për secilin pasuri; në Total 99.509.760 LEKË. Data e zhvillimit të ankandit do jetë 03.12.2018.
CEL. 0684026666 ; 0693262866 .

Njoftim për shitje me ankand të dytë

Sh "Power & Justice" (P&J) sh.p.k bazuar në nenin 568, 577e vijues të K.Pt.C do të zhvillojë ankandin e dytë për pasurinë e pales debitorë B Kamberaj dhe L Kamberaj. Pasuria që shitet në ankand përbehet nga :
- "Truall " e Godine të katëshe " : me numër pasurie 14283 ne Z K Nr.8602, volumi 35, faqe 144, truall 300 m2 , sipërfaqe e katit perdue 117,9 m2 ne Lagen 10 Korriku
Ankandi i dytë i pasurisë fillon me çmimin fillestar në masën 6.272.000 LEKË.
Ankandi qendron i hapur 30 dite dhe do të zhvillohet në datë 14.12.2018 në orën 15:00 në Bulevard "Gjergj Fishta" Kulla 1, Kat 2, Zyr nr. 5, Tiranë. Ofertuesit duhet të tërhojnë dokumentacionin të kontaktojnë me shoqërinë si dhe mund të vizitojnë faqen WEB www.powerjustice-at.com.

Njoftim për shitje me ankand

Shoqëria "Power & Justice" (P&J) sh.p.k bazuar në nenin 567, 568 të K.Pt. Cillo ka shpallur shitjen me ankand të pasurisë për pasurinë e pajualjshme të pales debitorë, hipotekeuse dhe pales dorëzuesë:
- "Tokë Aie" në Z.K 1987 me numër pasurie 3038 Volumi 19 Faqe 71, me sipërfaqe 1000 m2 me çmim fillestar prej 125.460 Euro
- "Tokë Aie" në Z.K 1987 me numër pasurie 4036 Volumi 11 Faqe 92, me sipërfaqe 1730 m2 me çmim fillestar prej 125.460 Euro
- "Tokë Aie" në Z.K 1987 me numër pasurie 2573 Volumi 15 Faqe 239, me sipërfaqe 2.000 m2 me çmim fillestar prej 122.640 Euro
Ankandi qendron i hapur për 15 ditë dhe do të zhvillohet në datën 06.12.2018 prej orës 15:00, pranë selisë në Bulevard "Gjergj Fishta" Pall i shoqërisë "Gora" Kulla 1, Kat 2, Zyr nr. 5. Ofertuesit mund të kontaktojnë me sh "Power & Justice" (P&J) sh.p.k dhe vizitojnë faqen WEB www.powerjustice-at.com.

Lista e qeverisë dhe Kuvendit për Bankën, nga Ridvan Bode dhe deputeti Mima, te pedagogia Luçi

Propozimet e Ramës për BSH, Bode dhe gruaja e deputetit të LSI

PD: Përdorim për diversione të brendshme

Valentina Madani

Kryeministri Edi Rama propozon Ridvan Bode për anëtar të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë si dhe bashkëshorten e deputetit të LSI-së, Vangjel Tavo. Mes tri emrave të propozuara nga qeveria tërheq vëmendjen ai i ish-ministrit të Financave në 8 vitet e qeverisë "Berisha", Ridvan Bode, i cili është tërhequr nga politika aktive pas përjashtimit që i bëri kryetari i PD, Lulzim Basha nga lista e zgjedhjeve të 2017. Suela Popa është gruaja e deputetit të LSI-së, Vangjel Tavo. Ajo ka qenë drejtoreshë e Agjencisë së Zhvillimit Bujqësor dhe Rural, AZHBR-së; ndërsa Edlira Luçi është pedagog e njohur, shefe e departamentit të Financës në Fakultetin e Ekonomisë, Universitetin e Tiranës. Kurse tri emrat e propozuara nga parlamenti mësohet se janë deputeti i PD, Florion Mima; dekani i Juridikut, Artan Hoxha dhe Arben Malaj, që propozohet për një mandat të dytë në Këshillin Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë. Nëse Florion Mima do të votohet nga parlamenti, atëherë do i hapë rrugë kreut të PAA, Agron Duka për të hyrë në parlament, pasi është emri i katërt në listën e PD-së në qarkun e Durrësit.



KUVENDI

Tri emrat e propozuara nga parlamenti janë deputeti i PD, Florion Mima; dekani i Juridikut, Artan Hoxha dhe Arben Malaj, që propozohet për një mandat të dytë në Këshillin Mbikëqyrës të BSH. Nëse Florion Mima do të votohet nga parlamenti, atëherë do i hapë rrugë kreut të PAA, Agron Duka për të hyrë në parlament, pasi është emri i katërt në listën e PD-së në qarkun e Durrësit.

Ridvan Bodes nga kryeministri Edi Rama për Këshill Mbikëqyrës të Bankës e Shqipërisë është rast që përdoret nga qeveria për diversione të brendshme në PD. I ftuar në "Ora News", deputeti Ervin Salianji tha dhe se ky është rasti i dytë, pas propozimit të Malinda Bregut në një funksion

qeveritar. Sipas tij, në të tilla raste PD i dhimben me shumë atë që përballen me arrogancën. "Qëndrimi im ka qenë i qartë prej kohësh në lidhje me çdo lloj funksionari të PD, që kush merr apo përfaqëson qytetarë të caktuar nuk mund t'i tradhetojë interesat e tyre. Nuk besoj dhe nuk

QEVERIA

Mes tri emrave të propozuara nga qeveria, Ridvan Bode, Suela Popa dhe Edlira Luçi, vëmendje merr ai i ish-ministrit të Financave në 8 vitet e qeverisë "Berisha", Ridvan Bode, por gjithashtu edhe emri i Suela Popës, e cila është gruaja e deputetit të LSI-së, Vangjel Tavo.

Meta në Rozhajë, në Mal të Zi: Respektimi i pakicave, një vlerë e shtuar

Presidenti i Republikës, Ilir Meta po zhvillon një vizitë pune në Komunën e Rozhajës, në Malin e Zi. Kjo është hera e parë që presidenti viziton këtë komunë ku banojnë shqiptarë. Banorët shqiptarë të Rozhajës dhe zonave përreth i kushtuan një pritje të ngrohtë kreut të shtetit shqiptar. Po ashtu, Presidenti Meta u prit nga zëvendëskryeministri i Malit të Zi, Rafet Husoviq, ministra dhe deputetë. Meta mori pjesë si i ftuar nderi në veprimtarinë tradicionale "Ora e Maleve". Ai u uroi shqiptarëve të Rozhajës dhe Malit të Zi Festën e Flamurit Kombëtar. "Shqiptarët në trojet e tyre në Mal të Zi duhet të ndihen krenarë për kontributin e dhënë për çështjen kombëtare shqiptare, sepse vendi i tyre është në pedestalin e historisë sonë. Respektimi i pakicave kombëtare është një vlerë e shtuar për të gjithë ne. Bashkëjetesa dhe fqinjësia me shqiptarëve e malazezëve si në Shqipëri e Mal të Zi, ashtu edhe në Kosovë është një udhërrëfyes i mirë për bashkëjetesën me pakicat e minoritetet kombëtare në të gjithë rajonin tonë. Shqiptarët në Mal të Zi kanë një kontribut të jashtëzakonshëm për këtë shtet, veçanërisht për pavarësinë e tij, si dhe për proceset integruuese të Malit të Zi, në familjen euroatlantike", - nënvizoi z. Meta.



VOTIMI

Emrat pritet që të votohen nga Kuvendi, ndërsa opozita e ka bojkotuar prej sesionit të ri parlamentar. Mandati i anëtarëve të Këshillit të BSH është 7 vite. Këta emra u përzgjedhën nga një listë me 38 kandidatë. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë zgjidhen nga Kuvendi dhe ushtrojnë këtë funksion me mandat 7-vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje. Pavarësisht përzgjedhjes nga kryeministri, kandidaturat kalojnë për votim në parlament. Ndërkohë që opozita bojkoton parlamentin, pritet që ish-ministri demokrat të marrë vetëm votat nga PS. Sipas ligjit të Bankës së Shqipërisë, të gjithë anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës zgjidhen dhe emërohen nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, mbështetur në propozimet e bëra si më poshtë: pesë anëtarë propozohen nga Kuvendi (aktualisht vakanca është për tre); tre anëtarë propozohen nga Këshilli i Ministrave dhe një anëtar propozohet nga Këshilli Mbikëqyrës. Deri në zgjedhjen e anëtarëve të rinj, Banka e Shqipërisë ndodhet në ngërc, pasi Këshilli Mbikëqyrës nuk mund të marrë vendime, njësoj si Gjykata Kushtetuese, apo Gjykata e Lartë. Në datë 21 nëntor dështoi për të dytën herë brenda 14 ditësh mbledhja normale e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, pasi ka vetëm 3 anëtarë, ndërsa 6 të tjerëve u ka mbaruar mandati dhe duhet të zgjidhen nga Kuvendi.

REAGIMI

Për demokratët, propozimi i

Zgjedhjet në PD, rikonfirmohen humbësit në krye të degëve

Ristrukturimi, Ristani: Zgjedhjet, transparente dhe gjithëpërfshirëse

PD është përfshirë në një proces ristrukturimi, atë të zgjedhjes së drejtuesve të rinj në rrethe. Prej datës 23 nëntor, në zbatim të urdhrit të kreut Basha, të gjitha degët kanë nisur zgjedhjet për drejtuesit e rinj, për t'i hapur rrugë mbledhjes së Kuvendit Kombëtar në 15 dhjetor. Të premtën procesi i zgjedhjeve është mbyllur në disa degë, të cilat nuk kanë sjellë emra të rinj, por rikonfirmime. Në Durrës u rikonfirmua si kryetar Ferdinand Xhaferrri, i cili prej më shumë se 1 viti e drejtonë këtë degë si i komanduar. Në Kamëz është rikonfirmuar Xhelal Mziu. Pritet që si kryetar të rikonfirmo-



het edhe deputeti Myslym Murrizi në Lushnjë dhe Luan Baçi në Fier. Në


NGA KORÇA, KUVENDI

Pas zgjedhjeve në degë, do të mblidhet Kuvendi Kombëtar i PD e më pas do të zgjidhen nënkryetarët e sekretariatit, moment që do të tregojë nëse lideri i opozitës, Basha, do t'i përfshijë apo jo kritikët në strukturat drejtuese".

qarkun e Shkodrës, zgjedhjet do të mbahen në datën 1 dhjetor, ndërsa pritet që postin e kryetarit ta kërkojë sërish Ramiz Çobaj. Sot demokratët e Korçës do të zgjidhen me kreut aktual të degës, Andrea Mano, i cili përballë ka Elvin Bregun. Në Sarandë garon Hariz Mema, ish-kreu i Aleancës Kuq e Zi

më pas kryetar i PD, ndërsa sfidues ka Shpëtim Iljazin. Zgjedhjet në rrethe përfundojnë më 3 dhjetor, duke i hapur rrugë Kuvendit Kombëtar, që voton këshillin e më pas zgjidhet kupola drejtuese e PD. Por fitorja apo rikandidimi i kryetarëve të zonave ku PD ka humbur thellë ka çelur një debat

brenda opozitës, nëse humbësit duhet të drejtojnë apo jo sërish PD-së. Për sekretarin e përgjithshëm, Arben Ristani, është anëtarësia ajo që përcakton kush do ta drejtojë. "Ne nuk e kemi një rregull në statut që në rast se humb një palë zgjedhjeje, nuk garon më. Në si rregull kemi parimin demokratik, nëse anëtarësia e do atë pavarësisht se humbi, sepse humbja ndikohet nga faktorë të tjerë. Për të mos i hyrë më tepër kësaj se në zgjedhjet e fundit ju i dini pretendimet që ka PD dhe gjithë shqiptarët për zgjedhje të manipuluar. Është një proces gjithëpërfshirës, demokratik, i hapur. Është një proces që duhet të ndodhë, sepse e kërkon statusi i PD", theksoi z. Ristani.


Tirana International Airport
 Nënë Tereza

TENDER OPPORTUNITY FOR DUTY FREE BUSINES at TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT SHPK (TIA)

Tirana International Airport (TIA) would like to inform the interested parties about the following tender opportunity at the Terminal Building, Departure Area. The airport is a transportation hub for Albania and it represents a unique and highly attractive location for all retailers and caterers with a double digit growth in passengers.

DUTY FREE
• Approx. 282 m2;

Prospective tenants are expected to meet the following requirements:

- Qualification and Experience with the object "Duty Free Management" (interested parties must provide examples / references); Information must be provided on similar current activities, number, size and location of outlets, years of operation, annual turnover in the last three years (or from the date of operation), total number of employees;
- Financial solidity, excellent standing and capability of the company; minimum relevant turnover in the last financial year of EUR 1,000,000 in the relevant field (interested parties must provide Profit & Loss statement of last three years);
- Relevant software/IT and data management experience concerning the Duty Free system used in the duty free areas managed by the company (interested parties must provide examples / references);
- To participate in this process interested parties will need to retrieve the Request for Proposal and sign the Confidentiality Commitment Document, which can be retrieved at Tirana International Airport, Administration Building, Rinas;
- Only to the companies that will submit the confidentiality commitment will be given the respective set of tender documents that contain the full information for submission of the proposals;
- The Request for Proposal will be distributed only on 07 December 2018 up to 14:00 Eastern Time, which, documents will be delivered in a CD, free of charge.

All inquiries and the Expression of Interest shall be addressed by hand or to all the following email address not later than 07 December 2018 up to 14:00 Eastern Time:

Tirana International Airport N'n' Tereza SH.PK
Administration Building
Commercial & Property Department
Rinas, Albania

Emails:	Alisa Gjinari	agjinari@tirana-airport.com
Commercial Department	Ilir Alimema	ialimema@tirana-airport.com
Legal Department	Albi Palushi	apalushi@tirana-airport.com
Procurement Department		



AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE. LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA, ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.




MERRNI NE KËRE REALE LAJMET E FUNDIT NE APARATIN TUAJ CELULAR SMARTPHONE OSE TABLET



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET KËRKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID







Implemente e
by
GIZ

Programme: Sustainable Regional and Economic Development, Employment Promotion and VET

The *Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit* GmbH (GIZ) is a federal enterprise that supports the German Government in achieving its objectives in the field of international cooperation for sustainable development.

Project Background
Within the context of bilateral development cooperation, the Republic of Albania and the Federal Republic of Germany agreed on the joint implementation of the "Sustainable Economic and Regional Development, Employment Promotion and Vocational Education and Training" program (short: ProSEED) in 2016. The overarching aim is to improve the employment situation of the workforce and self-employed, particularly of skilled youth, in the Albanian labor market.

The program has since its initial commissioning been amended three times, in that it currently runs from 01/2017 until 03/2022. The program has five components: (i) Technical and Vocational Education and Training (TVET), (ii) Promotion of micro, small and medium-sized enterprises (MSMEs), (iii) Social participation of youth and minorities, (iv) Strategies and frameworks for regional development, economic growth and employment and (v) Promotion of the innovation system.

In 2018, with the latest amendment, the European Union (EU) contributed funds under the framework of the Instrument for Pre-Accession Assistance 2020 for the Competitiveness and Innovation (C&I) Sector. The delegated agreement based co-financing extended the program by including measures to encourage innovative start-ups and to strengthening a corresponding environment (ecosystem) for start-ups and growing companies. As such, a fifth component (output V) was added to the ProSEED program. For this component (which actually has the size of a small project) the position of an Administrative Officer – Finance is hereby advertised.

GIZ Office Albania seeks the following staff: Administrative Officer – Finance EU co-financed project

A. Responsibilities
The Administrative Officer - Finance is responsible for:

- financial administration in accordance with EU and GIZ standard procedures
- financial planning (especially cash management), monitoring and accounting for the above mentioned EU co-financed project
- effective coordination with the staff of the finance team in GIZ-ProSEED, GIZ-Office Tirana and GIZ Headquarters
- administrative services for the above mentioned EU co-financed project with regards to financial issues, procurement, contract and travel management
- compliance of all financial and administrative interventions and activities of the project with quality assurance of contract documents (EU and GIZ) of the project

The Administrative Officer - Finance performs the following tasks:

B. Tasks
The Administrative Officer - Finance

- monitors income, expenditure and reports accordingly
- helps prepare project budget planning (system development for planning and monitoring)
- helps monitor expenses in accordance with the budget by collaborating closely with the responsible team members
- manages and monitors the monthly accounting and financial plans
- is responsible for financial management and monitoring, incl. reviews in SAP and cost control
- advises on financial aspects of projects and contracts
- prepares monthly and annual budgets and monitors deviations
- prepares annual financial reports in accordance with EU contract requirements
- prepares quarterly/annually analyses of expenditure compared to total project budget (budget monitoring) for both internal and external usage
- prepares financial contributions (financing agreements and local subsidies) and monitors their implementation jointly with the technical experts
- procurement, contract and travel management

Other duties/additional tasks
The Administrative Officer - Finance

- reports all problems with financial administration and compliance without delay
- is responsible for filing in accordance with EU regulations and GIZ rules
- performs other duties and tasks at the request of management

C. Required qualifications, competences and experience:

- university degree in Finance or several years of professional experience in the related field
- at least 3 years of professional experience in a comparable position
- ideally experience in the financial management of EU financed projects
- in-depth knowledge of the following softwares, Excel, MS Office. Knowledge of SAP and Cost Control would be a strong asset.
- confidential handling of data and information
- very good knowledge of English, ideally a knowledge of German
- willingness to upgrade skills as required by the tasks to be performed – corresponding measures are agreed with management

Contract conditions:

- Full-time employment
- Programme office in Tirana
- Assignment period: until 30.09.2021

Please forward your application until **2nd of December 2018**, to GIZ Office Albania by E-Mail: giz-albanien-hr@giz.de including the following information: Application letter, CV in English (Eu-ropass format), references.

Only short-listed candidates will be contacted for interviews. Short-listed candidates might be asked to bring certified copies of their diplomas and work certificates.

GIZ is an equal opportunity employer and welcomes applications from all interested groups without any discrimination!

Shoqërohen disa persona, ja dy pistat e hetimit

Atentati ndaj biznesmenit Agron Alushaj, policia: Eksplozivi u vendos brenda në makinë

VLORE - Një ditë pas ngjarjes së rëndë të ndodhur në lagjen "Kushtrimi" të Vlorës, ku pas një atentati me bombë me telekomandë mbeti i plagosur rëndë biznesmeni Agron Alushaj, policia ka shoqëruar dhe marrë në pyetje disa persona, por ende nuk ka asnjë të arrestuar. Mësohet se blutë kanë marrë në pyetje dëshmitarë në vendngjarje, në momentin kur ndodhi shpërthimi. Pas kryerjes së hetimeve paraprake, burime nga grupi hetimor bënë me dije se shpërthimi i së premtes në hyrje të qytetit bregdetar ka qenë i telekomanduar dhe mendohet se 48-vjeçari Alushaj ishte nën vëzhgim nga per-

PISTAT E HETIMIT

Policia dhe Prokuroria e Vlorës janë duke hetuar në dy pista për zbardhjen dhe dokumentimin e plotë të kësaj ngjarjeje. E para ka të bëjë me aktivitetin e 48-vjeçarit në fushën e ndërtimit dhe atë të gurores, ndërsa e dyta lidhet me faktin se motra e tij, Loreta Tozaj (Alushaj), ka mbajtur detyrën e drejtoreshës së Hipotekës së Vlorës.

sona të tjerë, të cilët i vendosen lëndën eksplozive në automjetin e tij tip "Benz" me targa AA703. Shënjestra e atentatit mbeti i dëmtuar në të dyja këmbët. Pasi mori ndihmën në spitalin rajonal të Vlorës, ai u transportua

në kryeqytet për një mjekim me të specializuar. Po të njëjtat burime pohuan se automjeti i Agron Alushajt shpërtheu në momentin kur po dilte nga një lavazh, pranë një pike karburanti. Sipas burimeve të më-

sipërme, Alushaj ishte në hapat e parë për ngritjen e një pallati në qytetin bregdetar, ndërsa është pronar i një biznesi guror në fshatin Drashovicë të Selenicës. Ndërkaq, policia dhe prokuroria e Vlorës janë duke hetuar në dy pista për zbardhjen dhe dokumentimin e plotë të kësaj ngjarjeje. E para ka të bëjë me aktivitetin e 48-vjeçarit në fushën e ndërtimit dhe atë të gurores, ndërsa e dyta lidhet me faktin se motra e tij, Loreta Tozaj (Alushaj), ka mbajtur detyrën e drejtoreshës së Hipotekës së Vlorës. Kjo e fundit (Tozaj) u



Biznesmeni i plagosur, Agron Alushaj

emërua drejtoreshë e Hipotekës në fund të vitit 2014 dhe u shkarkua në tetor të vitit 2018. Nga informacionet që jep policia, biznesmeni 48-vjeçar nuk rezultoi person me precedentë penale, por mësohet se Agron Alushaj ka jetuar për disa vite në Britaninë e Madhe. Gjithashtu, burimet në fjalë

sqaruan se lënda shpërthyesë dyshohet të ketë qenë brenda mjetit, pikërisht në vendin e shoferit. Kjo bazuar dhe në dëmtimin që automjeti ka marrë. Biznesmeni Alushaj ka marrë dëmtime serioze në trup, ndërsa mësohet se ai rrezikon të dyja gjymtyrët.

Familja Mulla hap dyert e mortit, presin kthimin e trupit të pajetë të 39-vjeçarit

Djalin ia vrau policia greke, nëna: Mos qani! E prita boll, se deshi jetën

Vendorët i dhanë lajmin e kobshëm për humbjen e të birit, 76-vjeçarja shtang nga dëshpërimi

VIKTIMA

Sipas burimeve policore, 39-vjeçari Altin Mulla ka qenë person me precedentë kriminalë. Më 13 mars të 2006-ës, Gjykata e Tiranës e ka dënuar atë me 16 vjet e 8 muaj burg për veprën penale "Vrasje me dashje", ndërsa u arrestua më 30 tetor të 2015-ës. Mulla i lirua nga IEVP Peqin, ku vuante dënimin për plotësim afati, më datë 3 gusht të 2018-ës.



39-vjeçari i vrasë, Altin Mulla

lajmi i kobshëm dhe nuk ka folur fare. Ajo ka hapur dyert e mortit, ndërsa banorë të zonës, por edhe miq e kush-

ërinj të familjes Mulla kanë shkuar për ngushëllim. Merzia, nëna 76-vjeçare e Altinit dhe dy djemve të tjerë, që është

të e vetme në shtëpi iu ka thënë atyre që të mos derdhnin lot për djalin e saj. Mbrëmjen e së premtes mbër-

DROGA

Burime nga policia greke bënë me dije se 39-vjeçari Altin Mulla, së bashku me 3 shqiptarë të tjerë po mundoheshin të kalonin nga kufiri 6 çanta me 13 pako që përbënin 166 kg e 200 gr marijuanë. Krahas sekuestrimit të lëndës narkotike, policia greke sekuestroi në vendngjarje edhe dy kallashnikovë.

Drejtonte trafikun nga Holanda, arrestohet shqiptari me 25 identitete

HOLANDE - Një shqiptar 37-vjeçar i njohur në Hollandë me nofkën "Akili" është arrestuar si kreu i një grupi të trafikut ndërkombëtar të drogës, që e drejtonte nga Amsterdam. Shqiptari, emri i vërtetë i të cilit është Xhevdet Plaku, kishte plot 25 identitete të ndryshme, bëjnë me dije mediat holandeze. Behet me dije se pakove të drogës u vinin emra sipas cilësisë së mallit që kishte brenda, duke i pagëzuar si markat e njohura të modës apo të luksit. "Hermes" titullohej kokaina më e pastër e më pas vinin "Lacoste", "G4", "Rolls Royce" e "Playboy". Shqiptari që importonte tonelata droge nga Holanda e Belgjika në Brescia u tradhtua nga përgjimet. Në pranga kanë përfunduar 56 persona.

hai i viktimës dhe një tjetër i afërm i tyre kanë shkuar në morgun e Janinës, kanë parë trupin dhe kanë konfirmuar se personi i vrasë ishte Altin Mulla. Ende nuk ka asnjë informacion se kur do të sillen në banesën e tij në Fushë-Vërrë, trupi i pajetë i 39-vjeçarit Altin Mulla.

DURRËS - Rreth 40 punonjëse të një të një rrobaqepësie në Fllakë të Durrësit kanë përfunduar dje në spital, për shkak të gjendjes së rënduar shëndetësore. Mësohet se punonjëset janë ndër keq në vendin e punës dhe kanë pasur marrje mendsh dhe këputje. Ndërkaq, burime zërtare nga policia e qytetit bregdetar bënë me dije se vetëm 8 punëtorë nuk janë ndër mirë dhe



Helmohen 40 punonjëse në rrobaqepësi, policia: Shkak kondicionerët, lëshuan gaz helium

kanë shkuar në spital. Nga veprimet e deritanishme të kryera nga grupi hetimor ka rezultuar se në ambientet e brendshme të rrobaqepësisë, në një cep kanë qenë disa kondicionerë. Sot disa punëtorë i kanë lëvizur kondicionerët për t'i nxjerrë jashtë ambienteve të

punës dhe dyshohet se gjatë lëvizjes kanë lëshuar gaz helium dhe ky ka qenë shkak që punëtorët nuk janë ndër mirë nga ana shëndetësore. Gjendje shëndetësore e tyre është përmirësuar, ku 6 prej të cilave kanë dalë nga spitali dhe 2 janë dërguar në spi-

tal në Tiranë jashtë rrethit për jetën. Në ambientet e Komisarariatit të Policisë Durrës është shoqëruar pranoi i rrobaqepësisë, shtetasi italian G.S. dhe po pyetet rreth rrethanave të ngjarjes", thuhet në njoftimin zyrtar të policisë.

Arbër Suló

DELVINË

Ekzekutimi nga policia greke i 39-vjeçarit Altin Mulla në kufirin greko-shqiptar (zonën e Janinës), pas shkëmbimit të zjarrit me një grup trafikantësh të drogës, mes të cilëve ishte edhe viktima ka tronditur tejet familjarët e këtij të fundit, të cilët të premtën kanë hapur dyert e mortit. Lajmi për humbjen e djalit, i cili kishte vetëm tremuj që kishte dalë nga burgu i Peqinit, ku kishte kryer dënimin prej 16.8 vitesh heqje lirie për një vrasje ka shokuar pjesëtarët e familjes Mulla nga fshati Fushë-Vërrë e Delvinës. Ndërsa e prisnin të kthehej në shtëpi dhe të futej në rrjedhën normale të jetës, Mulla nuk ka hequr dorë nga aktiviteti kriminal, gjë që i kushtoi edhe jetën. Me zemrën e thërrmuar nga dhimbja për vdekjen e të birit, Merzi Mulla u ka kërkuar të afërmeve dhe miqve të familjes që mos të qanin për djalin e saj. "Mos qani asnjëra! E prita boll, nuk e deshi jetën", është shprehur nëna e 39-vjeçarit.

NËNA E VIKTIMËS

Të premtën, pas konfirmimit zyrtar se personi i vrasë është shkëmbimit të zjarrit me policinë greke në fshatin Visani të Pogonit në Janinë është Altin Mulla, banor i fshatit Fushë Vërrë, Bashkia Delvinë, persona të autorizuar si kryeplaku i fshatit, administratori i Njësisë Administrative Vergo, inspektori i zonës dhe një bashkëfshatar nga lagja shkuan në shtëpinë e viktimës për të njoftuar familjen e tij. Në shtëpi ndodhej vetëm e ëma, 76 vjeç, e cila është habitur nga kjo vizitë e befte. Kryeplaku i fshatit ishte ai që iu drejtua nënës duke i thënë: "Tani ne na duhet të të themi se pse kemi ardhur këtu dhe në këtë orë. Jemi njoftuar se djali yt, Altini është vrasë në Greqi gjatë një shkëmbimi zjarri me policinë greke". E moshuara ka shtangur nga

TIRANË - Gjykata e Krimeve të Rënda ka lënë në burg pa afat 8 të arrestuarit për sasinë prej 587 kg kanabis të sekuestruar në Qafë-Thanë. Sipas hetimeve të Prokurorisë, grupi u zbulua pas përgjimeve të nisura prej tetorit 2018. Droga që u sekuestrua në Qafë-Thanë do të transportohej drejt Turqisë, fillimisht duke e kaluar me varka nga liqë-



Kanabisi do të shkëmbejë në Turqi me heroinë

Sekuestrimi i 587 kg drogë në Qafë-Thanë, Gjykata e Krimeve të Rënda lë në burg 8 trafikantët

ni i Pogradecit në Maqedoni dhe më pas në Greqi me destinacion final Turqinë, ku do të shkëmbejë me heroinë. Të arrestuarit akuzohen për trafik të narkotikëve dhe prodhim dhe shitje narkotikësh. Seanca me kërkesë të gjy-

tarit Bib Ndreca është zhvilluar me dyer të mbyllura, për shkak të ruajtjes së sekretit hetimor. Nga ana tjetër, avokatët mbrojtës i cilësuan provat e prokurorisë të paplota.

Në kërkesën e prokuror-

isë për caktim mase, e siguruar nga TV "Klan", rezultoi se kanabisi ishte blerë në Tepelenë nga Aranit Bida, që cilësohet nga organi i akuzës si drejtuesi i grupit. Ky i fundit organizonte transportin në aksin Tepelenë-Fier-

Rrogozhinë dhe Elbasan me destinacion Pogradecin. Më pas sasia prej 587 kg kanabis do të merrej në dorëzim nga Elvis Gjona, që përmes Suferim Dokollarit do ta transportonte drogën me varka nga liqeni i Ohrit drejt Maqedonisë. Nga përgjimet ka rezultuar se Aranit Bida do ta dërgonte kanabisin në Turqi për ta shkëmbyer më pas me heroinë, e cila nga Turqia do të transportohej për në Shqipëri.

Policia e RENEA "blindojnë" Lushnjën. Ja historia e gjobëvënies ndaj Baki Taullaut

Plagoset me breshëri kallashnikovi në lokal biznesmeni Saimir Taullau

Atentatorët e 47-vjeçarit u larguan me motor. Në vitin 2005, banda e Aldo Bares i ekzekutoi vëllain

LUSHNJË

Saimir Taullau është plagosur mbrëmë gjatë një sulmi me armë zjarri ndaj lokalit të tij. Mësohet se persona ende të paidentifikuar kanë qëlluar me breshëri automatiku ndaj objektit të tyre dhe më pas janë larguar me shpejtësi, me motor. Burime zyrtare nga policia e Lushnjës bënë me dije se ngjarja ku mbeti i plagosur biznesmeni 47-vjeçar ndodhi në vendin e quajtur "Rotondo e Plygut". Taullau është dërguar urgjentisht në spitalin e Lushnjës, ku ndodhet jashtë rrezikut për jetën. Mësohet se ai ka marrë vetëm një plumb në trup. "Në datën 24.11.2018, në vendin e quajtur 'Rotondo e Plygut', është qëlluar me armë zjarri në drejtim të lokalit të shtetasit S.T., 47 vjeç, banues në Lushnjë. Për pasojë ka mbetur i plagosur lehtë shtetasi S.T., i cili ndodhet në spitalin e Lushnjës nën kujdesin e mjekëve, jashtë rrezikut për jetën. Grupi hetimor ndodhet në vendngjarje dhe po punon për zbardhjen e plotë të saj si edhe identifikimin e autorëve. Në hyrje-daljet e qytetit janë ngritur pika të shumta kontrolli, me qëllim kapjen e autorëve të dyshuar", thuhet në njoftimin e policisë. Sipas bluve, Saimir Taullau është person me precedent penal. Ai është vëllai i Baki Taullaut, i cili është vrarë në vitin 2005, pasi bandat e Aldo Bares i vinin gjoba. "Kishim blerë një tokë në Tiranë dhe banda na kërkoi para ose tokën. Vëllai denoncoi në polici dhe në SHIK bandën dhe ata e kërcënuan se do e vrisnin", ka thënë në një intervistë para disa kohësh Taullau.

ATENTATORËT

Burime zyrtare nga policia e Lushnjës bënë me dije, se ngjarja ku mbeti i plagosur biznesmeni 47-vjeçar ndodhi në vendin e quajtur "Rotondo e Plygut". Taullau është dërguar urgjentisht në spitalin e Lushnjës, ku ndodhet jashtë rrezikut për jetën. Mësohet se ai ka marrë vetëm një plumb në trup, ndërsa atentatorët janë larguar me motor nga vendi i ngjarjes.



Lokali ku u plagos biznesmeni, Saimir Taullau

qytetin e Lushnjës dhe as në Tiranë, vetëm që i janë borxhli familjes". Në këtë rast, vëllai i tretë i Baki Taullaut nuk hezitoi të vinte gishtin mbi pjesëtarët e bandës së Lushnjës, duke i cilësuar këtë të fundit si përgjegjës për vrasjen e vëllait të tij dhe për gjobat e paguara nga ky i fundit, në adresë të pjesëtarëve të bandës.

GJOBAT

"Nga viti 1993 deri më 1997, kam qenë në burg, pasi isha i dënuar dhe kur u hapën burgjet, edhe unë si shumë të tjerë ika nga burgu dhe shkova në Itali. Atje ndjenja deri në fillim të vitit 2000, kohë në të cilën erdha, pasi vëllai im po kërcënohej rregullisht nga 'banda' e Alfred Shkurtit. Pjesëtarët e 'bandës' së tij, Ilir Stërgu, Arben Boriçi, Enver Dondollaku, Arjan Aliçko dhe Leonard Prifti (ky i fundit i vrarë), sajnin historit të ndryshme vetëm e vetëm që t'i merrnin lekë vëllait tim, Baki Taullaut që kishte një biznes.

Fillimisht ata kërkuan që unë t'i bashkohesha 'bandës' së tyre, por më pas meqë unë nuk iu bashkova, më akuzonin se isha pjesë e 'bandës' së Artur Dajës dhe po tentoja të hakmerresha ndaj tyre. Unë për herë të fundit e kam takuar Artur Dajën kur isha 17 vjeç dhe para se të bija në burg dhe që nga ajo kohë nuk e kam parë më. Pasi u ktheva në Shqipëri, vëllai Bakiu më tha 'nuk ke bërë mirë që ke ardhur'. Për këtë shkak më nxori një vizë dhe ika në Greqi ku ndenja disa muaj. Gjatë kësaj kohe, kam mësuar se Bakiu është detyruar t'i paguajë disa herë gjoba 'bandës' së Alfred Shkurtit, pasi e kërcënonin për jetën time dhe të vëllezërve të tjerë. Mesa di unë, vëllai ka paguar disa herë 'gjobat' e vëna nga Alfred Shkurti, Enver Dondollaku, Ilir Stërgu, Arben Boriçi, Arjan Aliçko, Leonard Prifti etj. Sic më ka thënë vëllai, kishte paguar njëherë si fillim 6 milionë lekë, të cilat i

kishin marrë Eduart Demiri dhe Ilir Stërgu për llogari të Alfred Shkurtit. Më pas 10 milionë të tjera të vjetra i janë paguar Enver Dondollaku dhe 6 mijë euro motrës së tij. Unë vetë personalisht bashkë me Eduart Demirin i kam paguar vëllait të Alfred Shkurtit, Zyberit, 6 milionë lekë të vjetra të cilat m'i dha vëllai Bakiu që t'ia jepja pasi i kishte vendosur Alfred Shkurti 'gjobë'. Kjo histori ka vazhduar edhe më gjatë, ku në rastet kur vëllai Bakiu nuk pranonte të paguante ata hakmerreshin ndaj biznesit të tij dhe kërcënonin pjesëtarët e familjes. Në vitin 2002, pasi vëllai kishte refuzuar të paguante 5 milionë lekë, ata të 'bandës', i vendosën tritol banesës së vëllait tjetër Albert Taullaut, i cili mbeti i plagosur. Gjatë kësaj kohe, isha duke pirë një kafe në një lokal erdhni një shtetas me emrin Genti Turku dhe më kërkoi të pija një kafe.

Pranova dhe shkova, kur

më dërguan te varrezat nga më doli Leonard Prifti me një pistoletë në dorë. Mua më thanë se të kërkonte Enver Dondollaku dhe atje më doli Prifti. Ky i fundit kërkoi që ta merrja vëllain dhe të shkoja pasi na kërkonte Alfred Shkurti te varrezat.

Shkova në shtëpi dhe i thashë vëllait Bakiut, të mos dilte se po e kërkonin ata të 'bandës' për ta vrarë. Këta të fundit kishin marrë vesh që vëllai kishte blerë një truall në Tiranë dhe i kërkonin që të paguante ose 500 mijë euro ose letrat e tokës.

Pas kësaj 'gjobe' vëllai nuk pranoi që t'i paguante dhe të shkonte të takonte Alfred Shkurtin. Ata, pjesëtarët e 'bandës' e kërcënuan se do ta vrisnin. Për këtë shkak, në më pas po ruheshim dukemose dalë. Vëllai i denoncoi tek drejtori i SHISH-it Xhevdet Zeq.

Ai i adresoi tek Antiterrori në Drejtorinë e Policisë së Fierit dhe Tiranës, ku vëllai dha



Blokojen ilaçe kontrabandë në pikën kufitare të Morinës

KUKËS - Specialistë të strukturave të Shërbimit Doganor Shqiptar kanë bllokuar në Pikën e Kalim-it Kufitar të Morinës një sasi mallrash dhe ilaçesh kontrabandë. Mësohet se gjatë kryerjes së procedurave të kontrollit, në automjetin furgon të tipit "Volkswagen", në pronësi të shtetasit më inicalet R.L.L., pas kontrollit në skaner ka rezultuar se në brendësi të mjetit ishin fshehur mallra të padeklaruar. Ndërkaq, gjatë kontrollit të imtësishëm të ushtruar ka rezultuar se ishin fshehur një sasi e konsiderueshme ilaçesh. Menjëherë strukturat e Doganës kanë bërë bllokimin e këtij shtetasi dhe të mjetit. Procedurat i janë përcjellë Hetimit Doganor dhe Policisë për ndjekje të mëtejshme.

dëshmi me detaje duke denoncuar të gjithë pjesëtarët e 'bandës' dhe gjobat e vendosura ndaj familjes sonë. Pas këtij denoncimi të kryer nga vëllai, "banda" e mori vesh dhe kërcënuan sërish se do ta vrisnin.

EMRAT/ 5 kËstet e kompensimit që do të shpërndahen nga fondi i ALUIZNI-t

Pronarët që ndajnë 200 milionë lekë të reja në Tiranë e në rrethe

Agjencia e Trajtit të Pronave (ATP) njofton se ka përfunduar procesin e shqyrtimit për 182 (njëqind e tetëdhjetë e dy) kërkesa, të paraqitura nga subjektet përfitues, pronarë të pasurive të paluajtshme, pronë private, të prekur nga ndërtimet informale, që përfitojnë deri më tani kompensimin/shpërbllimin në vlerë, në masën 70% të shumës së përgjithshme në të holla, të miratuar me Vendimet përkatëse të Këshillit të Ministrave.

Procesi i shqyrtimit të këtyre kërkesave dhe i shpërndarjes së fondit të kompensimit është bazuar në ligjin nr.9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", i ndryshuar, në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.383, datë 19.05.2010 "Për përcaktimin e procedurave të shpërndarjes së fondit të kompensimit në vlerë për pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimet informale", i ndryshuar, dhe në vendimet përkatëse të Këshillit të Ministrave, në të cilët është përcaktuar masa e shpërbllimit për secilin pronar.

Për 182 (njëqind e tetëdhjetë e dy) kërkesat më sipërme, për të cilat ka përfunduar procesi i shqyrtimit nga ana e ATP-së, ka rezultuar se dokumentacioni i tyre është në përputhje me kriteret e përcaktuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.383, datë 19.05.2010 "Për përcaktimin e procedurave të shpërndarjes së fondit të kompensimit në vlerë për pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimet informale", i ndryshuar.

Fondi financiar që shpërndahet nga ATP për këto 182 (njëqind e tetëdhjetë e dy) kërkesa, është në vlerën 203 614 601,15 (dyqind e tre milion e gjashtëqind e katërmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e një presje pesëmbëdhjetë) lekë. Të dhënat në lidhje me pasuritë që kompensohen dhe mbi gjeneralitetet e subjekteve përfitues jepen në listën bashkëlidhur këtij njoftimi.

Agjencia e Trajtit të Pronave (ATP) njofton subjektet e interesuara se vlerat përkatëse për secilin përfitues do të jenë disponibël në llogaritë e tyre në bankat e nivelit të dytë pas përfundimit të procedurave të transferatave bankare në ditët në vazhdim.

Table with 14 columns: Nr. rresht, Nr. kërkesës, Datë miratimi, Emri, Adresa, Qarku, Nr. i zotëris, Vlera e pronës, Vlera e kompensimit. Contains 182 entries.

Table with 14 columns: Nr. rresht, Nr. kërkesës, Datë miratimi, Emri, Adresa, Qarku, Nr. i zotëris, Vlera e pronës, Vlera e kompensimit. Contains 182 entries.

Table with 14 columns: Nr. rresht, Nr. kërkesës, Datë miratimi, Emri, Adresa, Qarku, Nr. i zotëris, Vlera e pronës, Vlera e kompensimit. Contains 182 entries.

PORTRET

Deri sot dihej se në Amerikë dikur kanë jetuar dhe vepruar vetëm dy fotografë me prejardhje shqiptare, Gjon Mili dhe Dhimitër Mborja (Bratko). Por, në mesin e tyre ishte edhe një tjetër...

RIÇARD ÇEKANI

Fotografi shqiptaro-amerikan për të cilin nuk kemi dëgjuar

Nga Fahredin Spahija*

Deri sot dihej se në Amerikë dikur kanë jetuar dhe vepruar vetëm dy fotografë me prejardhje shqiptare, Gjon Mili dhe Dhimitër Mborja (Bratko). Por, në mesin e tyre ishte edhe një tjetër...

"Gjeniu shqiptar" apo "shqiptari i çmendur" - siç e quanin amerikanët fotografën shqiptaro-amerikan Gjon Milin - ishte vetëm 19 vjeç kur me mbështetjen morale dhe financiare të dajës së tij, Koço Çekanit, më 1923 zbarkoi në SHBA për ta realizuar ëndrrën e tij amerikane! Koço mund të konsiderohet më meritori që Amerika fitoi një prej fotografëve më zhbërës në aspektin e zhvillimit të teknikave të reja fotografike, kurse shqiptarët fotografën më të madh dhe më të talentuar të të gjitha kohërave.

Ky shkrim nuk ka për qëllim të trajtojë jetën dhe veprën e "shqiptarit zemërbardhë" - siç e quante Milin tonë, dramaturgu i madh irlandez Sean O'Casey - jo pse për të nuk ka më çka të thuhet më shumë seç është thënë përmes shkrimeve e dokumentarëve të shumtë që ofrojnë të dhëna për veprën dhe jetën e fotografit unik shqiptar (jo rrallë edhe të pavërteta e gjëra të pabazura në fakte nga "studius" të vetëshpallur të Gjon Milit).

Do të ndalemi te Koço Çekani dhe një detaj tërësisht i panjohur deri tash. Koço - vëllai i nënës së Milit - ka ndihmuar të krijohet edhe një tjetër fotograf për të cilin nuk është shkruar asnjëherë në letrat dhe mediet shqiptare: Riçard Çekani (Richard Checani, biri i tij i dytë).

Riçard Çekani, siç figuron në të gjitha dokumentet dhe materialet që kam hulumtuar për të - deri tash krejtësisht anonim për ne - u lind në qytetin Natick të Massachusettsit, më 29 shtator të vitit 1929, nga babai Koço dhe nëna Evantia (Kreshpani) - që të dy nga Korça. Çifti Koço-Evantia rritën pesë fëmijë (vajzën Helen dhe djemtë Robert, Richard, Theodore dhe Charles). Ka të ngjarë që edhe Riçardi ndoqi studimet në MIT (Massachusetts Institute of Technology), si djalë i tij i hallës, Gjon Mili, sepse edhe ky kishte miqësi me profesorin dhe zbuluesin e madh të pajisjeve elektrike, Harold Edgerton.

Fotografitë që ka realizuar Riçard Çekani gjatë viteve '50-'60 të shekullit të kaluar tregojnë përpjekjet e



Riçard Çekani: "Goditje e topit të tenisit", (stroboskopi) 1950

Bashkëkohësi e kushëriri i Gjon Milit, koleksionit i korçarit të panjohur




Viktori Çekani (nëna e Gjon Milit) me vëllaun Koço Çekani (babai i Riçard Çekanit), 1922-1923

tij për të realizuar fotografi me tekniken stroboskopike, çka dëshmon influencën që kishte puna e Gjon Milit në krijimtarinë e tij. Meqë Riçardi ishte më i ri në moshë se Mili, ky i fundit bënte përpjekje që ta angazhonte atë në revistën "LIFE", për ta ndihmuar karrierën e tij si fotograf.

Kështu, në edicionin e revistës "LIFE" të datës 22 nëntor të vitit 1954, tek faqet 113, 114, 115, 116, 117, 118 gjejmë artikullin "The Rainbow-Parade of color shows begins to dazzle U.S.", që i kushtohet fillimit të përdorimit të televizorëve me ngjyra në Amerikë dhe realizimit të emisioneve të para televizive në teknologjinë me ngjyra. Të gjitha fotografitë që ilustron këtë shkrim janë të realizuara nga Gjon Mili dhe nga Richard "Dick" Checani (Riçard Çekani).

Riçard Çekani pjesën tjetër të jetës do ta kalojë në studion e tij fotografike në qytetin Elmhurst të Nju Jorkut, ku kryesisht bënte fotoportrete dhe fotografi për gazetat lokale. Njihet si koleksionisti më i madh i veprave fotografike dhe filmave dokumentarë të Gjon Milit. Një numër i madh i fotografive të stampuara dhe të nënshkruara nga vetë Mili, por edhe të vulosura



Riçard Çekani: "Trajektore e topit të golfit", (stroboskopi) 1950-1955



Riçard Çekani: "Nudo e përsëritur", (stroboskopi) 1950-1955

Njëra nga fotografitë e botuar në "LIFE magazine" të datës 22 nëntor 1954.

me vulën që ka mbishkrimin "Gjon Mili-The Richard Checani Collection", janë shitur apo shiten edhe sot nëpër shtëpi të njohura ankandi si pjesë e koleksionit të tij.

Riçard Çekani vdiq në moshën 81-vjeçare, me 26 nëntor të vitit 2010.

***Ish-drejtor i Galerisë Kombëtare të Kosovës**

E DIEL

25 Nëntor

2018



Fotografia e Parashqevisë në diplomimin e saj nga Kolegji i Vajzave në Stamboll, 1904. Ajo është në rreshtin në kembë, e dyta nga e majta. Nga koleksioni i Viktorias Dakos, përdorim me leje

Parashqevi

QIRIAZI

Si u mor "Himni i Alfabetit" nga Kolegji i Yale

Kongresi i Manastirit (14-22 nëntor 1908) ishte ndër kuvendet më të rëndësishme në gjithë historinë politike dhe kulturore të kombit shqiptar. Çështja kryesore ishte njësimi përfundimtar i alfabetit shqip, i cili qe i domosdoshëm për bashkimin e kombit. Kur flitet për këtë kongres, emri i Parashqevi Qiriazit duhet të nderohet po aq sa edhe burrat e Komitetit. Si përfaqësuese e Shkollës së Vashave të Korçës, ajo ishte e vetmja delegate femër në Kongres. Ajo u zgjodh sekretarja e Komitetit, duke punuar gjithë ditën me të njëmbëdhjetë. Në vitin 1909, Parashqevia shkroi "Himnin e alfabetit", botoi një abetare me alfabetin e ri, si edhe themeloi shoqërinë kombëtare për gra, "Yll" i Mëngjezit". Më vonë, në Amerikë, ajo botoi një gazetë me të njëjtin emër (1917-1920), e cila trajtonte tema patriotike, kulturore dhe arsimore për kontekstin shqiptar dhe amerikan. Në pothuaj çdo numër botohej abecja shqip, që të përhapej dhe të kuptohej. Deri tani, është hamendësuar se Parashqevia e ka kompo-

zuar vetë Himnin e Alfabetit, ose se e ka huazuar nga një marsh francez. Por cila është origjina e vërtetë e kësaj muzike?

... Midis viteve 1900-1901, këngës iu shtuan ca strofa të reja, jo më për sportin, por për vitet e shkollës, për krenarinë e të qenët student në Kolegjin Yale, për miqësitë që krijoheshin në kolegji, si edhe për besnikërinë që një student duhet të tregojë "ndaj Zotit, atdheut dhe Yale-it", teksa largoheshin e niseshin për të punuar në "botën e turbullt si deti". Më 1904, Parashqevi Qiriazia, si edhe motra e saj e madhe Sevastia, u diplomua në një kolegji amerikan protestant për vajza në Stamboll Constantinople Women's College (Sevastia u diplomua më 1891). Du-

het të hamendësojmë se pedagogët amerikanë të këtij kolegji e kishin sjellë në Stamboll këngën e Kolegjit Yale për të frymëzuar studentet, dhe se Parashqevi Qiriazia duhet ta ketë dëgjuar e kënduar këngën. "Adelina", studente ideale e Kolegjit Yale në folklorin e kolegjit. Kur erdhi koha që Parashqevisë i duhej një

muzikë e mirë për të frymëzuar shqiptarët për t'u bashkuar dhe për të ruajtur besën e dhënë në Kongresin e Manastirit, përballë trysnisë së krijuar nga xhonturqit, të cilët kundërshtonin alfabetin e ri, ajo e shfrytëzoi melodinë që ende oshinte në kokën e saj prej vitësh, duke qenë e sigurt se kjo muzikë mund të kë-

dohej lehtë dhe se do të kujtohej për një kohë të gjatë, deri në ditët tona! Për në Kongresin e Parë të Manastirit Komisioni pregatitor ftoi edhe motrën time Sevasti të përfaqësonte shkollën shqipe të vajzave në Korçë.

→ Vizion në faqen 14

Redaktor: Ben Andoni, 363

Në këtë numër: DAVID HOSAFLOOK, REXHEP FERRI, ARIAN LEKA, ERWIN EINZINGER, TATJANA HAXHIMIHALI, LAZËR STANI ETJ...

A

ARGUMENT

Emri i Parashqevi Qiriazi është shumë i nderuar, sepse u zgjodh sekretarja e Komitetit të Manastirit. Në vitin 1909, Parashqevia shkroi "Himnin e Alfabetit", botoi një abetare me alfabetin e ri, si edhe themeloi shoqërinë kombëtare për gra, "Yll i Mëngjezit". Më vonë, në Amerikë, ajo botoi një gazetë me të njëjtin emër (1917–1920), e cila trajtonte tema patriotike, kulturore dhe arsimore për kontekstin shqiptar dhe amerikan. Në pothuaj çdo numër botohej abecëja shqip, që të përhapej dhe të kuptohej. Deri tani është hamendësuar se Parashqevia e ka kompozuar vetë "Himnin e Alfabetit", ose se e ka huazuar nga një marsh francez. Por cila është origjina e vërtetë e kësaj muzike? Ajo tregohet në këtë numër, që autori e ka sjellë për "Milosao"...

PARASHQEVI QIRIAZI: Trëndafil mes burrave, yll mëngjesi

NGA DAVID HOSAFLOOK

Kongresi i Manastirit (14–22 nëntor 1908) ishte ndër kuvendet më të rëndësishme në gjithë historinë politike dhe kulturore të kombit shqiptar. Çështja kryesore ishte njësimi përfundimtar i alfabetit shqip, i cili që i domosdoshëm për bashkimin e kombit. Kur flitet për këtë kongres, emri i Parashqevi Qiriazi duhet të nderohet po aq sa edhe burrat e Komitetit. Si përfaqësuese e Shkollës së Vashave të Korçës, ajo ishte e vetmja delegatë femër në Kongres. Ajo u zgjodh sekretarja e Komitetit, duke punuar gjithë ditën me të njëmbëdhjetë.² Në vitin 1909, Parashqevia shkroi "Himnin e alfabetit", botoi një abetare me alfabetin e ri³, si edhe themeloi shoqërinë kombëtare për gra, "Yll i Mëngjezit". Më vonë, në Amerikë, ajo botoi një gazetë me të njëjtin emër (1917–1920), e cila trajtonte tema patriotike, kulturore dhe arsimore për kontekstin shqiptar dhe amerikan. Në pothuaj çdo numër botohej abecëja shqip, që të përhapej dhe të kuptohej. Deri tani, është hamendësuar se Parashqevia e ka kompozuar vetë Himnin e Alfabetit, ose se e ka huazuar nga një marsh francez.⁴ Por cila është origjina e vërtetë e kësaj muzike?

Midis viteve 1900–1901, këngës iu shtuan ca strofa të reja, jo më për sportin, por për vitet e shkollës, për krenarinë e të qenët student në Kolegjin Yale, për miqësitë që krijoheshin në kolegj, si edhe për besnikërinë që një student duhet të tregojë "ndaj Zotit, atdheut dhe Yale-it", teksta largoheshin e niseshin për të punuar në "botën e turbullit si deti". Më 1904, Parashqevi Qiriazi, si edhe motra e saj e madhe Sevasti, u diplomua në një kolegj amerikan protestant për vajza në Stamboll Constantinople Women's College (Sevastia u diplomua më 1891). Duhet të hamendësojmë se pedagogët amerikanë të këtij kolegj i kishin sjellë në Stamboll këngën e Kolegjit Yale për të frymëzuar studentet, dhe se Parashqevi Qiriazi duhet ta ketë dëgjuar e kënduar këngën. "Adelina", studente ideale e Kolegjit Yale në folklorin e kolegjit. Kur erdhi koha që Parashqevisë i duhej një muzikë e mirë për të frymëzuar shqiptarët për t'u bashkuar dhe për të ruajtur besën e dhënë në Kongresin e Manastirit, përballë trysnisë së krijuar nga xhonturqit, të cilët kundërshtonin alfabetin e ri, ajo e shfrytëzoi melodinë që ende oshinte në kokën e saj prej vitesh, duke qenë e sigurt se kjo muzikë mund të këndohej lehtë dhe se do të kujtohej për një kohë të gjatë, deri në ditët tona!

NGA PARASHQEVI QIRIAZI

Për në Kongresin e Parë të Manastirit Komisioni përgatitor ftoi edhe motrën time Sevasti të përfaqësonte shkollën shqipe të vajzave në Korçë. Vjeshtën e motit



Parashqevi Qiriazi

1908, për shkak të rrethanave politike të krijuara me shpalljen e regjimit konstitucional në Turqi, shkolla jonë u çel me një numër shumë më të madh studentesh se sa në vjetët e robërisë. Puna e shumë për të zmadhuar shkollën dhe internatin e penguan drejtorëshin të largohet prandaj ajo ma delegoi mua të drejtën e mandatin për të përfaqësuar shkollën e vajzave të Korçës në këtë Kongres të Parë Kombëtar, sikundër u quajt atëherë prej shqiptarëve. Si dihet, iniciativën e mori Killubi i Manastirit "Bashkimi",



Pjesëmarrësit në Kongresin e Manastirit

Për historinë tonë

Nga u mor "Kënga e alfabetit" Në fillim të shek. XX, ndeshjet e futbollit amerikan midis kolegjeve rivale Yale dhe Harvard ishin shumë të forta. Para një ndeshjeje në vitin 1900, një student nga kolegji Yale, Allan M. Hirsh, krijoi një këngë frymëzuese me emrin "Boola" për të motivuar studentët dhe tifozët e tjerë të Yale-it.⁵ Teksti i këngës thoshte guximshëm se Yale-i do të fitonte thellë dhe lojtarët e dërrmuar të Harvard-it do të qanin: "Bula bula, bula bu!". Si melodi, Hirshi e përshtati këngën e tij prej një kënge popullore me emrin "La Hoola Boola", kompozuar nga muzikanti afrikano-amerikan Bob Cole.⁶ Me të vërtetë, kolegji Yale-i e fitoi ndeshjen 28–0. Më 1905 kënga filloi të përdorej edhe nga Universiteti i Oklahomës dhe përdoret ende sot para ndeshjeve të tyre të sportit, me titullin: "Boomer Sooner".

Itan Hamitit. Përpara shpalljes së Hyrietit shkollat shqipe nuk mundën të vazhdojnë pa ndërprerje as për djemt e të krishterëve, dhe sa për djemt e mohamedanëve, atyre u qe ndaluar kateqoresisht të mësonin shkrim e këndim në gjuhën amtare. Dhe vete me mësueset e shkollës kur delnin nga shkolla, Mitropoliiti grek porositi rrugaçet të na shanin "Masonka, Protestante, Papiste" me gjithë se nuk ishim asgjë tjetër veç se shqiptare patriotë. Në një kohë të këtyllë, pra, kur sundonin kushte barbare për femrat, pa të drejta politike për ato, dhe gratë muhamedane në rrugë s'mund të delnin pa ferehe. Plotësisht e pa mundur dhe e pa dëgjuar që një grua të delte sheshit në një kongres burrash. ...

Im vëlla Gjergji që këshilltari kryesor i Killubit "Bashkimi" dhe iniciator kryesor i Kongresit, ai më keshilloi të mos ekspozohesh në Kongres e të mos dilnja në tribunë. Ai qe burrë i urtë dhe i mençur dhe me kulturën e tij të gjerë kish fituar simpatinë e miqve të Shqipërisë edhe mund të them respektin e të huajve. Me gjithë këto pengesa mua prapë mu dha një rast i mirë të shërbëni në Komisionin që zgjodhi Kongresi për të caktuar abecën. Ky komision i bënte mbledhjet në shtëpi të Gjergji Qiriazi i cili qe edhe kryetar i tij. Nëna jone, Maria, ishte e pamundur, por unë ndihmoja zonen e Gjergjit për të pritur e përcjellë ... anëtarët e komisionit të cilët punonin me ditë të tëra të veçuar për të shikuar çështjen e alfabetit, por edhe dhënë dorë duke mbajtur shënime për Komisionin. Por puna ime gjatë Kongresit qe e fëmëre [d.m.th.]. Ajo që nuk zgjat më shumë se një ditë", D.H.]. Ajo që mbeti në formë konkrete dhe e dobishme prej dorës sime, punë e frymëzuar prej Kongresit të Parë të Manastirit, është botimi i abetares sime të hartuar sipas rregullave që vendosi Kongresi vetë. Kjo abetare, e para e llojit të saj, doli pas disa muajve dhe u lajmua prej shtypit kombëtar si një punë e vlefshme. "Bashkimi Kombëtar" me 5 të Vjeshtësë Tretë 1909 shkruante: "Kjo libër e vogël me 32 faqe dhe me 18 fytyra ishte radhitur bukur e pas [?]... me abecën që vendosi Kongresi i Manastirit". Abetarja vërtet mbajti çmimin 20 para copa por e vërtetë është se ajo u shpërndajë gratis jo vetëm të [?]... por edhe në gjithë nxënësit e shkollave shqipe të atëherëshme. Që në Kongresin e Manastirit turqit edhe grekërit treguan planet e tyre ndaj shqiptarëve. Bënë çmos që të merret alfabeti arab edhe grek për të shkruar gjuhën shqipe. Për të luftuar punën e vlefshme të Kongresit të Parë të Manastirit dhe për të penguar mbrohtësinë e popullit shqiptar t'arryer me gjuhën amtare, xhonturqit nisën fushatën kundër abecës shqipe duke botuar një abetare të tyre me shkronja arabe. E zemëruar nga kjo punë e keqe e xhonturqvet kundër abecës aty për aty shkrova himnin e alfabetit kombëtar i cili u këndua në

...nga numri i shkruar

"Milosao" e këtij numri ishte relativisht e mirë. Ndoshta po të zgjidhje më mirë faqja e parë do të kishte shumë më tepër impakt. Këtë numër e hapëm me një editorial për panairin, që në vëzhgimin e redaktorit nuk kishte shumë ndryshim me vitin e shkruar. Botuesit arkëtuara para dhe kjo i bëri të kënaqur. A mjafton kjo vallë? Panairi është thjeshtë dhe ka mbetur një treg i madh dhe pak më i lirë i shitjes së librit. Asgjë më shumë. Në të gjitha aspektet duket sikur problemet i kanë në kurriz vetëm botuesit, por në një farë mënyre edhe ata vetë, jo pak prej tyre, janë pjesë e problemit të sjiellë. Gjithsesi duhet urren Panairin dhe mjesditi shumë festiv, që sjell ashtu si duhet kritikuar gjithçka që lidhet me padrejtësinë, që edhe njerëzit e librit e kanë kultivuar jo pak mes vite. Në fakt, pati reagime të pakta për shkrimin e redaktorit dhe kjo do pritet pak më vonë sepse botuesit tanë nuk ta falin reagimin... Siç ndodh zakonisht, karakteret e vështirta tipografike faqesja jonë nuk i realizon dot. Dhe, kjo ishte vërejtja shumë e shqetësuar e autorit të tekstit për gazetën e parë shqiptare që u regullua disi në momentet e fundit... Kolegu ynë Ilirian Agolli na solli një shkrim të ndërper për gazetën e parë shqipe. Shkrimi solli fakte të reja mbi botimet e para publicistike në Shqipëri. Falë historianëve turq, publiku ynë mësoi se gazeta "Iskodra" ka dalë në ditë 11 vjet më parë nga ç'e dinë deri sot bibliografat e shtypit shqiptar. Pra, "Iskodra" doli për herë të parë më 1868 dhe ridoli më 1879. Redaktori shtoi dhe një shkrim për "Nëntorin-2018" dhe shprehu shqetësimin se megjithëse aktiviteti e ka gjetur gjuhën e tij dhe ka krijuar fizionominë, ai përcillet në formë shumë

mohuese. Paqja se moshat përfaqësuese shkojnë nga 20 deri afër 90, shqetësim është i njëjti: Fati i vendit, i shqiptarit dhe vazhdimisht kërkimi në koncept dhe mjete shprehëse, shkroi redaktori që ka pak vërejtje sa i përket disa elementëve të Nëntorit. Antropologu Doja solli një shkrim dhe një krahasim mes Ismail Kadarese dhe Mit'hat Frashërit. Duhet bërë çmos për të bashkuar gjithë shqiptarët dhe përfurcuar dinjitetin e Shqipërisë me çdo kusht, pavarësisht nga përcarjet e mëparshme dhe kusuret që kemi mbartur, vërejtje ai. Shkrimi ishte pak akademik dhe jo shumë realitetit të "Milosao". Kurse Luan Rama pas një mungese jo të pakët na solli një rrefim të bukur për Leonardon dhe stratotët. Për organizimin e festës përkujimore të fitores në betejën e Marignano-s, në pranverën e vitit 1518 Leonardo Da Vinci punoi bashkë me Bokalin dhe stratotët e tij, të cilët do të ishin pjesëmarrës në këto ndeshje kalorësiake. Vetë Leonardo nuk na ka lënë shënime rreth këtij spektakli, por ambasadorë apo pjesëmarrës të tjerë na kanë lënë disa përshkrime që tregojnë përmasat e këtij spektakli të organizuar me gjeneralitet nga ana e Leonardos, siç e kishte zakon ai të organizonte shumë festa për mbretin duke përdorur fishekzjarrë, ballona, e elementë të tjerë inxhinjerikë, shkroi ai. Në fund, dr. Irena Gjoni solli një shkrim për një libër, që redaktori duhej ta ruante për numër tjetër, duke menduar se mund t'i kushtonte vëmendje ndonjë risie të këtij panairi. Dhe, ky është gabim sipëror i tij dhe i të gjithë aspektit sesi po qaset të "Milosao" në javët e fundit. Layout punoi me vështirësi për faj të redaktorit, që solli shkrime masive.



...educational Mission School
...teha, Albania, 1929

katër anët e Shqipërisë më 1909: Sot është dita shqiptëtare të përpigëmi Alfabetin ton' të mbrojmë, Shpejtjo burrani. Shkronjat tona jan' të arta, Këto duamë.

Refreni: Shqipëri, atdhe i dashur Ne s'të lemë ty të varfër. Shkronjat ton' kanë për të mbrojtur Me gjithë shpirt shqiptëtarisht.

2. Arëmiqtë o shqipëtarë po përpigëni Shkronjat turçe dhe gërgishte Të na japinë. Le t'i mbajnë ato për vete, Kemi tonatë.

3. Ata duan shqiptarë ndarjenë tonë. Këtë punë shumë kthjellët e treguanë. Ngrihuni pra t'u tregoni se ju si i ndroni

Udhëtimi nga Korça për në Manastir e bëmë atë kohë me dy ditë. Nuk më del nga mendja nata që ngrysën në han të Stenjë. Katër burra dhe dy gra në një kthinë trualli pa tavan e pa oxhak. Me rrobat e udhës e me pallton e madh krahëvet u mblodhëm të gjithë rreth zjarrit të ndezur në mes të vatrës me tymin që ntrashesj sa me shumë, se s'kish nga të dilte. Natën e dhime me biseda kombëtare dhe rreth çështjes abecesë dhe herë-

here duke dëgjuar ndonjë shaka prej xha Mihalit (Grameni) i cili ndërsa dërdh-nim lot prej tymit, përpigje të na bënte të qeshnim. Kur arrimë në Manastir një ditë para se të çelej Kongresi qemë pa gjumë e të lodhur prej udhës. Edhe ky udhëtim edhe Kongresi vetë më shtynë të mendohem se ç' duhej bërë për ta shpë-tuar gruan nga gjendja në të cilën kred-hej. Përveç Abetares dhe Himnit të Alf-abetit, vendosa ashtu e heshtur, që kur të kthehesha në Korçë, të ftonja shoqet e mija të qytetit dhe së bashku të fillonim organizimin e një shoqërie kombëtare për gruan. Brenda vitit e themeluan, me emrin "Yll'i Mëngjezit" me qendër në Korçë edhe me degë nepër qytetet e tjera të Shqipërisë.

Burime:

1. Priti, Kristaq, red. Historia e popullit shqiptar, vëll. II. Tiranë: Toena, 2002, f. 391-396.
2. "Kujtimet e Parashqevi Qiriazi mbi Kongresin e Manastirit", AqSH F.57 (Parashqevi Qiriazi), D.1 (Veprimtaria krijuese).
3. Qiriazi, Parashqevi D. Abetare prej P. D. Qiriazi për shkollat e para. Manastir: Shoqëria "Botonjëse Literara", 1909.
4. Psh., te [https://sq.wikipedia.org/wiki/Alfabeti_shqip_\(kënga\)](https://sq.wikipedia.org/wiki/Alfabeti_shqip_(kënga)) (lexuar më 17 nëntor 2018), ku thuhet: "Muzika [e Himnit të alfabetit] është adaptuar nga një marsh i Revolucionit francez".
5. Hirsh, Philip, "The Secret Source of That Silly Tune", http://archives.yalealumnimagazine.com/issues/00_10/boola.html (lexuar më 15 nëntor 2018).
6. Shapiro, Fred R. "You Can Quote Them", http://archives.yalealumnimagazine.com/issues/2009_09/arts_quot057.html (lexuar më 15 nëntor 2018). Shih edhe: Powell, Azizi, "La Hoola Boola, The African American Source of the Yale University Song Boola Boola & The University of Oklahoma song Boomer Sooner", te: <http://pancocojams.blogspot.com/2014/04/la-hoola-boola-african-american-source.html> (lexuar më 17 nëntor 2018).
7. Sipas Sevasti Qiriazi, kënga u këndua në mitingun e shkronjave në Korçë në shkurt, 1910, ku u mblodhën rreth 12 000 pjesëmarrës. Ajo shkruan: "Pas fjalimeve njerëzit kënduan Himnin e alfabetit, i cili ishte kompozuar posaçërisht për këtë rast prej motrës sime, Parashqevisë. Himni i rregullt që të gjithë dhe qysh nga ajo ditë është kthyer thuajse në himn kombëtar" (Qiriazidako, Sevasti, Jeta ime jetëshkrimi i pabotuar i "Mësueses së Popullit" Sevasti Qiriazidako, Tiranë: Instituti për Studime Shqiptare dhe Protestante, 2016, f. 171-175).

ARGUMENT

Të gjithë, pra, njerëzit që merren me librin janë fajtorë për mosleximin, ndaj më e mira gjë që mund të thuhet në këto kohë është të heshtësh, të vepros dhe të mos presësh. Duhet që vetë njerëzit e librit të tregojnë sesa mund ta kthejnë këtë frymë negative dhe të trandin atë shifrën e frikshme të 1 milion njerëzve që nuk lexojnë...

Të gjithë e pranojnë mosleximin, por jo përgjegjësinë

NGA BEN ANDONI

Ka një zgjidhje për t'u thënë të gjithë personazheve që e pohojnë mos-leximin dhe tregojnë me gisht vetëm shtetin. Leximi varet nga individit. Shteti inkurajon me mekanizmat e veta ose thjesht e ndihmon me mbarëvajtjen e mirë. Të gjithë i janë turur shtetit, me të drejtë, pasi ky i fundit në rastin më të mirë i bën fushatat për lexim, si paradhoma për zgjedhjet. Rastet e javëve të fundit e provojnë këtë. Ndërkohë që shteti, bashkë me të gjithë aktorët që bërtasin për librin, mund ta kishin gjetur gjuhën deri më tani, të paktën ta zbrisnin TVSH-në nga masa 20% në një kuotë që të mos i vriste njerëzit e librit. Pasi njerëzit e librit bërtasin vetëm për uljen e TVSH-së. Në fakt, kjo nuk ndodh, kurse për çdo vit premtohet dhe pastaj gjithçka humbet.

Më për të ardhur keq është qarja për çdo vit në Panair të protagonistëve për vetë problemet e librit. Me asnjë mëdys-hje, shkaqet sociale, ekonomike, politike janë të parat, por aman nuk veçohet dhe makufëria e shumicës së Shtëpive Botuese dhe politikave të tyre. Shumica nuk promovon autorë, por promovon projekte, sepse shumë nga librat sponsorizohen. Të thuash se botuesit janë të varfër, atëherë të vjen të qeshësh, sepse në të vërtetë shumë syresh janë realisht të pasur... dhe shumë cinikë. Dhe, më keq akoma, në kritikë permanente për shtetin, nuk kemi dëgjuar të bëjnë ndonjëherë Mea Culpa të pastër, sesi nuk dinë të bëjnë njëherë zgjedhje të drejta. Pse ankohe gjithnjë për njëri-tjetrin pas mbarimit të panairit dhe më shumë akoma: pse nuk prodhojnë vlera? Këtu ka heshtje...

Libri shqiptar ka një fat, që nuk e ka

pasur në kohën e komunizmit, por që atëherë lexohet shumë e shumë më tepër. Tashmë tregu shqiptar është shumë i madh dhe përfshin një treg gati ballkanik. Kjo duhet t'i bëjë botuesit, njerëzit e librit dhe të gjithë aktorët e tjerë të mendojnë mekanizmat sesi libri të shkojë në të gjithë fshat e shoqërisë shqiptare.

Po shteti çfarë duhet të bëjë me këtë rast? Duhet ta mbyllë soditjen dhe të përfundojë Ligjin për Librin, duke ngritur Qendrën për Librin bashkë me strukturat e veta. Harru-



am Ministrinë e Arsimit, por ky institucion me ato kurrikula dhe me atë liberalizim që u ka bërë teksteve dhe politikave e saj do të jetë gjithnjë difektos dhe gabimet e mbartura do t'i vuajmë për shumë e shumë kohë.

Të gjithë, pra, njerëzit që merren me librin janë fajtorë për mos leximin, ndaj më e mira gjë që mund të thuhet në këto kohë është të heshtësh, të vepros dhe të mos presësh. Duhet që vetë njerëzit e librit të tregojnë sesa mund ta ndryshojnë këtë frymë dhe të trandin atë shifrën e frikshme të 1 milion njerëzve që nuk lexojnë. Dhe, të mos kujtohen vetëm në Nëntorin e Panairit të Librit.

(Milosao)

P

POEZIA

Një poezi si ajo që shkruan Erwin Einzinger kërkon shumë. Ajo ka harruar se jetojmë në shoqërinë e spektaklit. Ky poet zotëron lëndën poetike që del nga kaosi i jetëve tona. Ky listim i padobive tona, i mburrjeve, i mendjehëtisë duket se na tremb. Edhe pamja e pazakonshme një poeti që mban shënim jetën tonë në përfaqësimet e veta të ulëta na tremb. Ai inventarizon ekzistencën në formën më të zbehtë...

Në fund të çdo mbrëmjeje tepron një piring i madh kotësish, që i hyn në punë poezisë së Erwin Einzinger-it¹

NGA DR. ARIAN LEKA

Nuk ka shumë për të thënë rreth poezive të mia. Unë shkruaj rrallë dhe çuditërisht atë që shkruaj e bëj për kënaqësinë time...". Kështu shprehej poeti austriak Erwin Einzinger, kur libri i tij i parë me titullin e çuditshëm *Gjuhë qingji të paketuara në celofan (Lammzungen in Cellophan verpackt)* u vlerësua me çmimin letrar Georg Trakl.

Por a do të mjaftonte vetëm çmimi Georg Trakl dhe titulli i çuditshëm i librit për ta bërë lexuesin të kthejë vështrimin nga poezia ndryshe e Erwin Einzinger-it? Çfarë mund të priste lexuesi nga një poetikë si ajo, që braktis rëndësinë dhe seriozitetin e zakonshëm për të sjellë pamje plot humor të befasishtëm dhe ndriçimin e tehut të ironisë?

Të gjithë e vëmë re, po nuk na pëlqen ta themi. Në fund të çdo mbrëmjeje pas shpinës sonë mblidhet një piring i madh kotësish. Janë mbetje nga ditët që çuam kot. Por nëse pyesim se çfarë mund të bëjmë me këtë lëndë të pavlerë që na ngeci në duar, i vetmi arsyetim që na vjen ndër mend është: të nxjerrim prej saj se paku ndonjë përfitim, ta riciklojmë kotësinë dhe të rrethojmë mbi të.

Erwin Einzinger sillet ndryshe. Shkruan poezi prej kësaj lënde. Listimi ka filluar që nga libri i tij parë. Pa poetizuar gjë. Pa thurje të imta dhe fjalë marramendëse. Në listën e tij gjenden pamjet e përditshmërisë së botës, ku nuk mungojnë njerëz, kafshë, pemë, objekte dhe diçka e padukshme që syri nuk ka mundur ta kapë pa ndihmën e një poeti vrojtues si Erwin Einzinger.

Por pamjet, aty çalon puna, nuk janë hiç të denja për poezinë që lëvdohet e që mësohet përmendësh në shkollë. Pamjet janë aq të rëndomta sa, pas leximit të këtyre poezive nuk na dhimbset më bota, por vetja jonë, që fillon të dallojë se njeriu mbi piringun e kotësive nuk qenqësh kurrkush tjetër veç tij.

Vetëm një sintaksë kokëfortë, si ajo e gjermanishtes ndoshta, duket se mund të vendosë pak rregull në gjithë atë deformim. Është shturur natyra jonë, realiteti dhe bashkë me të edhe rendi njerëzor, apo mendja e një autori si Erwin Einzinger i bën më të afërta pamje sytë tanë nuk i rrokon dhe teknika nuk dëshiron të na i sjellë më pranë. Fundja pse duhet ta lejojmë poezinë të na e prishë iluzionin e jetës së mirë e të bagatë? Përse të mos i kthehemi asaj poezisë së bukur dhe me rima që parakalon si një model përballë adhuruesve të virtinave, tabloidëve dhe sfilatave?

Një poezi si ajo që shkruan Erwin Einzinger kërkon shumë. Ajo ka harruar se jetojmë në shoqërinë e spektaklit. Ky poet zotëron lëndën poetike që del nga kaosi i jetëve tona. Ky listim i padobive tona, i mbur-



rjeve, i mendjehëtisë duket se na tremb. Edhe pamja e pazakonshme një poeti që mban shënim jetën tonë në përfaqësimet e veta të ulëta na tremb. Ai inventarizon ekzistencën në formën më të zbehtë.

Erwin Einzinger mban shënim. Ai shënon pa reshtur mbi copa letrash të rastit dhe në fletore, por unë nuk i kam dhënë ende përgjigje pyetjes se pse një lexues i vitit 1977 duhej të zgjidhte librin e Erwin Einzinger dhe pse duhet të vazhdojë ta lexojë edhe sot një poet si ai?

Le ta bëjmë mbi trupin tonë vete. Çfarë mund të shkuanim ne mbi temën "Muzika e ambulancës"? A ka diçka për të shprehur aty, sidomos kur ambulanca nuk ka muzikë, por një sirenë që të prish qetësinë dhe kur fjala kalbëzim, për shembull, nuk ndjell

Poezia

Një poezi si ajo që shkruan Erwin Einzinger kërkon shumë. Ajo ka harruar se jetojmë në shoqërinë e spektaklit. Ky poet zotëron lëndën poetike që del nga kaosi i jetëve tona. Ky listim i padobive tona, i mburrjeve, i mendjehëtisë duket se na tremb. Edhe pamja e pazakonshme një poeti që mban shënim jetën tonë në përfaqësimet e veta të ulëta na tremb. Ai inventarizon ekzistencën në formën më të zbehtë.

aspak mirë? Po fëmijëve tanë çfarë mund t'u sugjerojmë nëse u duhet të shkruajnë diçka rreth "Monologut të marmaladës" apo të jepnin një mendim se çfarë ndodh "Në morgun e qefujve", apo të rendisnim se çfarë i ndodh botës në njëmbëdhjetë vite & dy muaj e gjysëm? Me çfarë do t'i mbushim radhët e fletore, por bisedat në kafene, në klasa dhe auditore, kur nuk kemi gjë për të shprehur për pamje si këto dhe pamjet e tjera të qyteteve, siç shfaqen në poezinë e Erwin Einzinger?

E shihni pra se poezia që shkruan Erwin Einzinger nuk është aspak e lehtë për t'u shkruar. Për t'u lexuar jo se jo. Ajo është po aq e vështirë sa edhe profesioni prej mësuesi dhe prej përkthyesi, të cilat ecin prej dekadash së bashku me këtë poet. Është pothuajse një antipoezi, pasi Erwin Einzinger nuk zgjedh enkas tema të veçanta dhe të çuditshme për poezitë e tij.

Ai madje ka shpërfillur atë me të cilën poezia është lëvdua prej motesh. Ka asgjësuar pothuajse krejt atë vetën e dashur intime: "unë". Te poezia e tij syri i brendshëm struket. Ai sy funksionon për të tjerët jashtë tij. Sidomos kur ky tjetri është një "ai" dhe një "ajo" që mbante kokën mënjanë / që i ka thyer zemrën / që studion tërë nxitim orarë e udhëtimin të transportit publik / që merr në telefon shpërndarësin pakistanez të picave / dhe që harron njëjloji si gëllsat e pulave & Hardrock-un nga mëngjesi në mbrëmje.

Nëse edhe për Erwin Einzinger duhet gjetur një tipar, siç bëjmë për të gjithë, mund të them se ky tipar është vëzhgimi. I vrullshëm dhe imcak. Ky poet sillet pakashumë me shprehjet e gjuetarit. Ai nuk ia rremben dhe as ia vret jetës pamjet. Ai kap në çarkun e tij disa nga pamjet që vetë jeta nuk dëshiron t'i përdorë. Përse e bën këtë? Ndoshta i dhimbson ato pamje dhe përpiqet t'i shpëtojë brenda një dorëshkrimi. Ndoshta ka lindur me dhuntinë e riciklimit, prej nga nxjerr sërish lëndë të parë.

Po çfarë kam vërtur tjetër në pamjet e përditshmërisë, që m'i afron mu para syve kjo poezi? Mos ndoshta kjo përditshmëri e poezive të Erwin Einzinger konkurohet nga kronikat televizive, nga *column* dhe *review* të gazetave apo na fotografitë që bëjmë me instrumentet tona *smar*?

Gjithë sa kam ndeshur aty rri larg prej lajmeve të ditës. Duket sikur kjo poezi mbush zbranzinë e krijuar nga komunikimet false, nga frazat boshe, nga ndodhitë e zhurmshme dhe nga fjalët që vrasin lart. Ndonëse u rri pranë "personazheve" të tij, Erwin Einzinger nuk harron thujtë kur të ruajë largësinë, gjë që me sa duket ka bërë të mundur që ai të mos familiarizohet me ta sa t'i shohë me dhimbje, t'i falë apo t'i vijë ndot prej tyre.

Çfarë tjetër më ka shpëtuar pa u vënë re, mes detajeve të shumta të këtyre poezive me densitetin e një romani të mirë? Po ja se ku shfaqet edhe një koncert me muzikë dhome. Ka kohë që ka mbaruar, por ku zonzëjmë, që ia ka këputur gjumit duhet ta prekin disa herë mbi sup, që të zgjohet apo të mos gërhijë.

Pastaj shfaqet një balerinë amatore që, në hutim e sipër, i bie me kokë një dollapi prej xhami. Pastaj shohim këpucë prodhuar prej letre dhe mbetjesh kartoni. Pastaj duket një vocërrak, teksa ecën me një karamelë në gojë dhe që mban veshur çizmet e tij me goma të trasha me bateri. Ja edhe një krijesë dembele, femër, me çizmet ngjyrë vjollcë, e cila ndalet mu para syve tanë për të fotografuar lulet e shkelura të një feste. E pastaj...?

Në poezinë e Erwin Einzinger-it ka vend edhe për tubat mabajtës në autobusë që janë ngrohur nga duart e nxehta të pasagjerëve



edhe për shitës të mallrave me pacicë dhe për një lavanderi të vogël në Sheffield, në atë lagje ku kurvat janë shtuar shumë edhe ku çarçafët ndonjëherë mbajnë një aromë kundërmuese të gëlasat e pulave.

Edhe për bastet e garave me kuaj, për shtëpiake, për një fëmijë me papuçe dhe pizhame, djem shakatarë dhe falltarë të fshehtë ka vend. Secili sjell pamjen dhe ndodhinë e tij të vogël. Po pastaj? Epo mirë. Jetohej edhe pa poezi. Për këto e për më shumë sa kaq mund të flitet edhe javën tjetër, siç mbyllet kreuja pa rëndësi gjendja e nderë të poezia *Kudo duhet të jesh ti*.

Nuk mund të thuhet të gjitha në një tekst kaq të shkurtër sa ky, por më shumë për të sajuar një mbyllje sesa për t'i dhënë shpjegim poezive të Erwin Einzinger-it, mund të pyes se çfarë drejtin duan dhe aq më keq çfarë presin njerëzit në një poet që u ka koleksionuar pamjet sikur t'u pastronte mbe-turinat në një qytet të ndotur nga kujtimet? A nuk u ka dhënë ai shenjë që, nëse nuk denjojnë t'i shkruajnë, se domosdo, nuk janë përnj-mend poezi, le t'i mbledhin e t'i koleksionojnë?

Të ndodhë ç'të ndodhë. Shohim e bëjmë si do shkojë fati i mbetjeve të përditshmërisë. Ndërkohë, Erwin Einzinger do të vazhdojë të bëjë të njëjtën gjë. E mërzitshme dhe monotone. Ai do të bëjë të bëjë punën tonë, pa e gënjyer aspak mendja se po shpëton botën dhe pa pretenduar se ajo që ai shkruan (sikundër dhe unë tani) do u pëlqejë të gjithëve.

Ja pra që Erwin Einzinger paskësh pasur të drejtë kur, në vitin 1977, teksa nderohet me çmimin Georg Trakl, tha: Nuk ka shumë për të thënë rreth poezive të mia. Unë shkruaj rrallë dhe çuditërisht, atë që shkruaj, e bëj për kënaqësinë time.

Shënime

¹ *Ligjëratë e mbajtur në përrurim e poezive të zgjedhura të poetit austriak Erwin Einzinger.*

ERWIN EINZINGER

Muzika e ambulancës

Ç'ka ndodhur deri tani: Koncerti i muzikës së dhomës ka kohë që ka mbaruar. Zonjzëzën e prekën disa herë në kurriz & ajo mbante kokën mënjanë. Mbi frutat e njoma: dritë yjesh.

E hënë. Një balerinë amatore i bie me kokë një dollapi xhami të shndërruar në një lloj vitrine, në të cilën – ç'marrëzi! – shihen këpuce prodhuar prej letre dhe mbetje kartoni. Në anën tjetër të rrugës tani tingëllojnë Melodi flauti nga malet e Ekuadorit ose Perusë. „Ikim atje, babi!” thotë një vocërak që ecën me çizmet e tij Me goma të trasha me bateri, me një karamelë në gojë. Në vitrinën e një shitësi me pacicë në një ekran të madh Video mbresëlënëse të digës me tri grykë.

Toka te sheshi para katedrales është ende E mbimbushur me lule. Shumë prej tyre tashmë janë shkëlur Ose do të shkelen. Por më parë një krijesë dembele femër Me çizme ngjyrë vjollcë do t'i fotografojë. Epo mirë!

Monologu i marmaladës

Çfarë e neverit më shumë nusen: se një ditë gjithçka mund të ketë vërtetë disa shijen e gomës. Miqësisht përshëndet shoferi pensionist i trenit, lehtas shkruajnë një koleg pune vajzën e tij më të vogël, ai mban emrin Erkenbald & është pjesë e detyrave të tij të kujdeset për elektronikën.

T'ia nisim dhe njëherë nga e para: As këtu Nuk bëhet fjalë për zëra të qashtë & të qenurit miqësor, as për pyetjen se pse tubat mbajtës në autobus që janë ngrohur Nga duart e nxehta të pasagjerëve, gjithë ditën Nuk duken të kenë kohë të mjaftueshme për t'u ftohur.

A ishte poterja, jo më e orëve të largëta, Që ndihej më së miri në atë cast, ajo që donte të përmbyste Çka vetëm fare pak u përmend? Mbi tapetin e vogël të folklorit ishte një botim Si libër xhepi i një versioni rumun të historive Të Shinderhanesit & u ledhatua nga drita E dobët që vinte nga jashtë. I Bibliotekës Së vogël të Bashkisë ishte një libër që ishte marrë hua prej vitesh & pastaj nuk u kthye më kurrë mbi Historinë e minierave të argjendit & në një pecetë

Që jepte përshypjen se ishte tejet e përdorur, në të cilën Ndoshta dikur ishte futur ushqimi për një udhë - Tim, poshtë fare ishte shkruar fjalia E çuditshme: “Atë ditë ndjeva shumë ankth.”

Pak para mesnate u ankorua trageti. Ndërkohë një Adelë e trishtuar Hoqi në dhomën e saj Sipër mbi rrugica vathët & u shtrij mbi dyshek. Nën mbulesën e linjtë të kafazit të zogjve flinte Papagalli i saj që mbante emrin e një tregimi me vargje të epokës baroke.

“Nëse për një kohë të gjatë nuk bie shi, fluturave u pëlqen të ndalen Pas lokalit që ndodhet pranë lumit Në rërën e bregut, që të thithin Me noçkat e tyre të brishta pak lagështi. Në mur tek bari varet Zjarrfikësi. Në ekranin e madh del një reklamë Modeste e Shoqatës së verëbërësve Me dy vajzuke të veshura hollë, buzëqeshja e të cilave u thotë të gjithëve: Sa bukur është këtu.”

Kudo duhet të jesh ti

Pothuajse në dritën e fundit të ditës: tutje, tutje mbi kodër Ose shpate, kaluar shtëpive mbi pemë & tabelave të reklamave për shpëlarës goje & automjeteve të parkuara të ndërtuesve të gëzuar të kanaleve. Nga një baxhë druri lavirret një zinxhir hekur. Përpara murit me tjegulla në një të ashtuqajtur erëmbrojtës – zonës Hyrëse të një shtëpie përdhese gri – është një tufë me tulipanë Plastikë. Me të vërtetë disa prej bimëve të vërteta të kësaj zone Varen disi. A nuk mund të marrin shembull Nga gratë trime të një qyteti të largët breg= Detar të mbyllura në një kullë, të cilat një ditë Nisën të rebeloheshin egër? – Mos vallë edhe kjo rrjedh Në fund të fundit nga një histori e mbajtur jashtëzakonisht fshehtë, nga E cila sot kanë mbetur vetëm detaje të turbullta në rastin më të mirë? Shiko, atje përpara retë pothuajse po puthin binanë e një pallati Të ri! Me sisë të ngjeshura, lopa e errët rri në rrëzë të pyllit & në krah të shpatit një traktor rrotullorë disa herë rreth një Peme që ka rënë prej disa javësh. Sikur ajo të mbetet mjaft kohë Në atë vend & pozicion, mund të bëhej myk & si i tillë, me atë erën tipike, të lidhej edhe me atmosferën Në fillim të një romani të zhdukur, në të cilin një udhë= Tar në orët e mbrëmjes hyn në një shtëpi të për= Shkuar nga ajri i freskët, ndërsa pas tij shushurin Pylli i zi, ku dikur djali i një veterinerereje Të vlerësuar nga të gjithë fqinjët ka gërmuar nën rizomën E një lisi të rrëzuar nga stuhia, pa një pa dy, një Vrimë, në mënyrë që t'i mundësonte kufomës së një qeni një Vend të fundëm qetësie të përjetshme. (Më shumë rreth kësaj, javën tjetër.)

Ode e borës së shkrirë

Zündapp: emër idiot për një motoçikletë. Po, gjithçka kaq gri sot, kaq e mjerë si një Kalendar baxhoje, vetëm dorashkat ndrisin. „Hë, u bë?” pyet roja i shkollës & ia rras Me këmbën e shëndetshme disa herë shkallës së poshtme. Prapë dy raketat lodër tregojnë Mbi parmakun e dritares në kat të parë Në drejtim të veriut, andej nga era shtyn Shtëllungat e ngjeshura të reve. Iken Ditet e lumtura, sepse një mbulesë bore iu këndua & ajo u përshëndet me thënie gazmore. Janë karnavalet. Burri me kapele me puçla nuk Ndihet. Mos vallë dikush do Të shohë skena të veçuara me lupën e kohës, bashkë me Regjistrimet e zërit, të cilat shkarazi mund të vërtetë= Ojné, se si bora e shkrirë gjatë Kalimit të rrugës plaquritit & lag lëkurën Artificiale të këpuçeve si të Meckit? O borë e shkrirë! O drita të alarmit! O ju që vetëm ankoheni para kafenesë Së vogël! Është koha e pluhurit që të jep të kruara, çdo Fëmijë e di. Nga e di? Epo, ndoshta nga gjyshja.

Përktheu: **Admira Poçi**

E

ESE

Një përsiatje gati epike a autorit, që nuk ka rend në kohë, në mendime dhe shpalosje. I rëndësishëm për të është të nxjerrë atë që e mundon më shumë...

PA LEJEN E ZOTIT

NGA REXHEP FERRI

1.
Në Ishullin e marrëzrivave, të famës së rre-
rshme, shtrihet vendlindja e Bjeshtëve të
Nemuna.
Aty rrufeja vret edhe pa lejen e Zotit.
Në krahun e ëndrrave mashtruese, duke
pritur më shumë se dy mijë vjet, pse moj të
besoj!
Ekziston dhuntia e besimit.
Legjenda e Bjeshtëve të Nemuna është
legjenda më e lashtë.
Brenda asaj legjende ka një magji dhe një të
vërtetë.
Ndoshta është vetë natyra.
Gjatë rrotullimit të tokës, jeta është valë
uji mbi det.
Shpresoj se fillimi na pëlgen.
Edhe kur jemi në qejf vazhdon qetësia.
Pritja është diçka tjetër.
Duke pikturuar natyrën, të mos harrojmë
ku ishim.
Të zbulojmë se ku po shkojmë.
Ku të kthehem.
Ku të ikim.
Këtë kërkesë shpirtërore e dija, por nuk i
besoja.
Më mirë të mendoj diçka tjetër.
Nga goja ime nuk duhet të dalë kjo faqe e
zezë.

2.
Lindja ime është diçka më shumë se një
frymë-marrje.
Me të kaluarën që nuk harrohet çka të
kërkoj kur asgjë nuk ka më vlerë.
Lindja ime ka qenë lindje nga gryka e push-
kës.
Pas Luftës së Parë, pas Luftës së Fundit.
Nga Plava e gjysh pas gjyshit shkuaq në
Shkodër. Nga Shkodra në Tropojë. Nga
Tropoja e nanës në Kukës. Nga Kukësi ku
unë kam lindur, im atë, për ta hapur sh-
kollën shqipe shkuaq prapë në Plavë. Nga
Plava, me nënën shkuaq në katundin e
tezës Razë, në Babaj të Bokës. Nga Babajt e
Bokës në Gjakovë.
Duke kërkuar kohën time, shkova në Pejë.
Nga Peja në Beograd. Nga Beogradi në Par-
is. Nga Parisi, ku nuk e gjeta veten si
francez, zbrita në Prishtinë.
Aty u ndala.
Isha i ri.
Për të zbuluar e gjetur vetveten në Prish-
tinë takova një studenteshë.
E ndala.
Ajo vajzë nuk kishte shoqe të dytë.
As tani s'kam si të mendoj ndryshe.

3.
Për ta përfjetuar ngrohtësinë e Atdheut, pas
vdekjes së Enver Hoxhës kalova nëpër geg-
ninë e gegëve.
Nëpër toskërinë e toskëve.
Të gjitha ato takime, histori, shëtitje tani a
janë kujtimet e mia?
Nga inati nuk po më vjen të them se të gjitha
ato takime nuk e kishin ngrohtësinë e
njëjtë.
Edhe pse të gjithë ishin lindur e rritur nga
prindërit shqiptarë.
Në disa shtrirje atdheu për ta ishte pyetje e
lehtë.
A ka kush të ma tregojë arsyen?
Nuk dua të çmendem.
Ishim ilirë.
A jemi ilir?
Ishim Albania Veneta.
A jemi Albania Veneta?

Ishim Albania Bizantine.
A jemi Albania Bizantine?!
Ishim Albania Turka.
A jemi Albania Turka?!
Ishim e ishim, e ishim...
A jemi e kush jemi e ku po shkojmë?!...
Për t'i shëruar plagët, njeriut nuk i duhet
më shumë se kaq.
Kjo frikë vlen për të gjithë.
Për të shpëtuar nga vetvetja, përpara prapë
më doli:
- Lumi.
- Deti.
- Oqeani.
- Dhe prapë lufta.
- Lakmia.
- Vrasja.
- Tradhtia.
Për t'i harruar kufijtë e paqartë të tragje-
dive të përditshme, dhimbja e njerëzve e
humb kuptimin.
Në pasqyrën e fatit na del një zemër që ha-
pet e mbyllet me çelës.

4.
Pse lehin qentë?
Kur nuk dijmë se çka të bëjmë.
Kush jemi?
Duhet të durojmë.
Edhe atëherë kur nuk jemi kurrkund.
Përse mos të bie nata.
Ndoshta nuk është keq.
Jeta është garë e një ëndrre të shkurtër.
Nëse nuk kemi kohë dikush tjetër mund ta
ruajë qetësinë.
Në këtë botë të rrejtshme gjithçka të bën për
jetën.
- A ta vrasim naivitetin?
- Ndoshta nuk kemi të drejtë.
- Po të dalim nga lëkura, ku do të shkojmë?...
- e pyeta veten.
Atdheu im torzo nuk mund të mendohet as
si kohë e shkuar e as si kohë e tashme.
Koha e tashme nuk është aspak më e mirë
se koha e shkuar.
Hap pas hapi prapë na vjen një luftë tjetër.
Për historinë e pashkruar ajo luftë peshon
më rëndë se malet e Bjeshtëve të Nemuna.
Me nostalgji e pa nostalgji duke mos lënë
asgjë pas vetes.
Jo me njerëz, por afër tyre.
Nuk shkohet më në luftë.
Gjatë luftës unë e kam luajtur rolin e hum-
bësit.
Rolin e Don Kishotit.
Dhe rolin e zjarrfikësit në pension.
Mendoj se rolin e Don Kishotit e kam luaj-
tur si të ishte Don Kishoti shqiptar.
Tani radhën e kanë artistët me zemër e pa
zemër.

Fund e krye me famë të rrejtshme.
Në fotografinë e parë i shohim krah për krah
me armikun.
Në fotografinë e dytë, për një cigare drogë,
kërkojnë një minutë pushim.
Në fotografinë e tretë, duke kaluar mbi Urën
e Shenjtë, nga turpësia e tyre thonë:
- Ura po dridhet!...

5.
Më lini pak vetëm.
Tani na doli një patriotizëm dinak.
Për njerëzit qesharak.
As të lindur, as të përgatitur për patriot soj-
li.
Duke mbledhur para me thes, të gjithë
vrapojnë pas famës së rrejtshme.
Takimet me ta nuk kanë kuptim.



Në ato takime ka vetëm gënjeshtria që janë
të turpshme, që na shiten shtrenjtë.
Për vijën e hollë mes vetullave, me respekt
për jetën, para zbritjes në Hënë, një
këshilltar amerikan i oborrit tonë
mbretëror, para dhjetë dite ka dhënë
dorëheqje duke thënë se nuk dëshiron të
jetë pjesëtar i tradhtisë historike që po e
bëjnë patriotët shqiptarë.
Nga kjo etnografi kush mund të na sigurojë
qetësinë e fjalës besnike.
Sot koha është një ditë me ngjarje të shpejtë
ta si magjia mashtruese me letrat e bix-
hazit.
Në të gjitha kombinimet çudia është magji.
Unë i jam mirënjohës edhe kur e kam larg.
I kujt është ky varr? Zotëriu që nuk i bëhet
vonë për asgjë më tha:
Kjo tokë është e gjithkujt dhe e askujt. E
vërteta vetëm pas vdekjes flet.

6.
Gjatë viteve kur isha student në Beograd,
nga pyetjet që nuk mora përgjigje, shtatë
vjet në ditarin e rinisë nuk kam shkruar
asnjë poezi.
Ndërrimi i rrethit, ndërrimi i vendit më
duket se për mua ishte me fat.
Një ditë profesori im Rajku më tha:
- Ferri, ju atje poshtë jeni kush jeni bashkë?
Ju, shqiptarët me serbin lak rreth qafës.
Serbi me ju shqiptarët lak rreth qafës. Ku
ta di, ndoshta frymëmarrja bizantine po u
mban gjallë.
Unë profesorin tim e shikova dhe qesha.
Ai singërisht vazhdoi rrëfimin:
- Këtë histori nuk e di sa e kupton? Më mirë
është të besosh! Njeriu duhet të jetë
mbrojtës i fatit të vet.
Tani po më vjen ta kuptoj shumë më qartë
profesorin tim.
Historia nuk shihet dhe nuk lexohet menjë-
jëherë.
Më vjen keq që e humba përgjigjen.

Shtatoren e heroit të panjohur vetëm ne
shqiptarët ende nuk e kemi.
Na duhet të presim.
Emrin e atij heroi e kemi nëpër shekuj të
humbur.
Kjo vepër arti kërkon kohë.
Në Rrafshin e Kosovës, gjatë luftës së fun-
dit, hasmi i droguar provoi ta dhunojë edhe
një vajzë të vrrarë.
Një virgjëreshë të vdekur.
Vajzat e gjalla kishin ikur.
Nuk kishin ku të kthehen.
- Hyr!
- Ku të hy?
- Në varr! - tha një vajzë me shtatë plagë te
pragu i shtëpisë.
- Kush do të qajë për mua? - më pyeti!
Fati i saj i zi i kishte dy kohë...

7.
Për të ecur ku janë ligjet?
E mandej këmbët...
Hasmi është duke na shikuar.
Çfarë vlerë kemi.
Për ne nuk ka as ligje as ndalesa. Prandaj
po flasim për gjithçka. Mos harroni të përf-
shini në mesin e gjithçkaje emrat dhe esh-
trat e të pagjeturve.
A ka edhe secreta që nuk do t'i kemi të njo-
hura kush ka guxim të pyet.
Si ta kthejmë besimin?
Si ta shpëtojmë fytyrën?
"Po shkelim në gjak deri në gju dhe s'ka më
lot". Bekim Fehmiu e shprehu epikën: "Nje-
riu këndon pas luftës".

8.
Duke luajtur e duke u tallur me errësirën,
neve shqiptarëve kurrë nuk na bëhet vonë.
Vetëm ashtu mendojmë.
Ndoshta kemi të drejtë.
Asnjëherë nuk kemi qenë më të çmendur.
Me një të gjallë e një të vdekur, kur u ndala
ishte vonë.

Më thanë:
Vizatoje një hartë me një të tretën e
Bjeshkëve të Nemuna.
Thashë:
Jo!
As për mikun e as për hasmin, jo!
Për muhabetin në çarshi gjejeni dikë
tjetër.
Nga e zeza që shkon vesh më vesh, prit-
ni pak.
Dëgjojeni frymëmarrjen e hapave të
heshtur.
Me të ardhmen e me të shkuarën për-
balluni çdo ditë.
Jo për ëndrrat e mia, por me vetveten.
Tani po më kujtohen gjërat që kanë
ndodhur dhe ëndrrat që e kanë hum-
bur rrugën.
Në ato ëndrra ka diçka shumë më të
madhe se hëna e madhe artificiale.
Për të kisha dëgjuar edhe para lindjes
sime...

9.
Me nëntë plagë të Gjergj Elez Alisë, sh-
tatë vjet e shtatëdhjetë e tetë ditë luftë
pa fitues, luftë pa humbës.
Flamuri i kujt po valon?
Ka mundësi të jemi edhe... edhe...
Koha nuk po pret që t'i themi të gjitha.
Në barakat e morgut të Spitalit të Prish-
tines ende i kemi thasët e zi të plastikës
me eshtrat e të vrarëve pa emra.
Pyetja e fundit është:
Edhe sa janë të pagjetur, të humbur e
të pavarrosur, si njerëz?
Emrat e tyre dikund janë.
Jo të fshehur, por për arsye të turpshme
në faqeziut i thashë:
- Ti je njeri i madh, por pse mban edhe
kapelë me madhësi aq qesharake?!...
Ai më tha:
- Ndryshe nuk po ma qet! Edhe kur i
hudhi plehërat dëshiroj të jetoj afër
mbretit. Tani si shpëtohet fytyra as unë
nuk e di. Nga zemra e plastë po më vjen
e kaluara e humbur që po më mban
gjallë. Për të mirë e për të keq. Para meje
lakuriqet e natës fluturuan shpejt, edhe
pse ata thajse janë të verbër...
Duke menduar se kush jemi e ku e hum-
bëm ëndrrën, rrëfimet e jetën i pashë si
një shans që fillon dhe mbaron larg dhe
afër.
Nga patologjia mashtruese nuk pashë
asgjë më shumë se jetën tonë pikë e
pesë.
Deri në perëndim të diellit futjani
lapsin.
Askush nuk ju pyet për asgjë.
Mentaliteti ka lëvizur.
Mes shqiptarëve, pajtimi zgjati vetëm
një ditë.
Le të paraqitet ai që pati sukses të na
pajtojë.
Një ditë... Një ditë...
Kurrë nuke mora vesh pse i bëmë gjithë
ato luftëra.
Në kërkim të njeriut, jeta të çon gjith-
kund.
Tani nuk ka rrugë që na merr, as valë
që na kthen.
Rreziku jo po nëlqen.
Edhe kur humbin nuk besojmë.
Në faqet e para të gazetave dhe në
televizion.
Për ta fshehur historinë nga historia.
Atdheu im torso është adresa e gjakut
të derdhur deri në gju.
Për ta kuptuar vajin e burrave.
Si mendim, vetëm si mendim është i
tmerrshëm.
Sa është tragjike nuk mund të jetë e
vërtetë.
Dhimbja të mbetet mes nesh.
Kuptojmi kohën dhe merrni aq sa e
ardhmyja juaj kërkon.
Vaji i burrave nuk është as teatër imiti-
mi, as vaj me lot krokodili, as vaj me
lot skleroze.
Mos më besoni!
Më lini vetëm.
Fytyrës i ka ikur ngjyra.
Syve u ka humbur shikimi.
Gojëj u ka mbyllur goja.
Pa ndonjë arsye tjetër.
Sa është tragjike vetëm shpirti e di!...

R REVIEW

Me ndjeshmëri artistike autorja përshkruan keqardhjen e banorëve të Tokës kur panë vendin krejt periferik që zë Toka në foton e marrë nga Voyager 1 ('1990). Atë kohë kur planeti ynë i parë nga miliarda kilometra larg u quajt Pale Blue Dot – Pikë e Kaltër, prej ngjyrës së oqeanëve dhe të qiellit të saj. Tekstet e librit shpesh janë ilustruar me foto, nga të cilat fotoja e Tokës e parë nga Hëna është një nga më tërheqëset, jo vetëm për cilësinë, por edhe se tregon se ç'arritje të papërfytyrueshme kanë bërë misionet për njohjen e universit!

Një libër sui generis i Mimoza Hafizit - “Pika Trëndafil – Për ne dhe alienët”

(Roman shkencor)

NGA DR.TATJANA HAXHIMIHALI

E është një nga botimet shkencore popullore të dala nga shtypi javët e fundit që do t'i përshtatet më bukur thënia e fizikanit të shquar Stephen Hawking se “Shkenca nuk i bindet vetëm arsyes, por edhe romancës dhe pasionit”. Një libër si ky nuk mund të shkruhet pa pasion, vetëm nga dëshira e profesoreshës së mekanikës kuantike, Hafizi, për ta njohur lexuesin me kërkime nga fusha e saj e studimeve. Po aq sa me arrijtje e të dhënat edhe nga qendra evropiane kërkimore me të cilat ajo bashkëpunon si astrofizikane, veçanërisht në studimet e pareshura për zbulimin e planetëve e fenomeneve të njohura e të panjohura të Universit.

Në një kohë kur, siç dëshmohej në libër, shkenca e formimit të yjeve dhe e sistemeve planetare po përjeton një revolucion jo vetëm me zbulimin e mijëra ekzoplanetëve (planetë që ndodhen jashtë sistemit tonë diellor) në ndjekim guximin e eksploratorëve të sotëm të qiellit në vazhden e zbulimeve të hershme që nga koha e Aristotelit të Greqisë së vjetër, kur shumë planetë u pagëzuan me emrat që kanë edhe sot. “Të fluturojmë në qiell me guximin e Magelanit dhe Kolombit që zbuluan botë të reja”.

Është e qartë se historiku i eksplorimit të hapësirës u bë i mundur vetëm kur teknologjia u lejoi astronautëve të dilnin jashtë atmosferës së tokës. Raketat e kanë ngritur njeriun dhe shkencën në hapësirë. Që nga sputniku i parë që u rrotullua rreth tokës, njeriu i parë në kozmos nga rusët, “Programi amerikan “Apollo Space (vitet 1963 deri 1972), Stacioni ndërkombëtar i hapësirës, (që qëndron në orbitë nga 1998), një nga arrijtjet më të mëdha të teknologjisë, me ekuipazhin që punoi dhe jetoi në hapësirë, teleskopi i hapësirës Hubble ('1990) me zbulimet e tij të panumërta, sonda e hapësirës Galileo që mbërriti në Jupiter (1995), sonda që zbriti në Mars dhe na hoqi kuriozitetin për jetën e gjallesave në planetin e kuq (2012) etj. Njohim përpjekjet e shkencëtarëve dhe studiuesve të kozmosit për arrijtjen e synimeve të tyre nga anë të ndryshme të botës nëpërmjet teleskopesh modernë të vendosur në vende që meritojnë statusin yjor të vëzhgimit (Kili, La Silla dhe në disa zona të Amerikës etj.), kryesisht në ambiente të larta e pa smog dhe gazra, larg sinjaleve të qindra milionë telefonave celularë, apo komunikimeve GPS me satelitë artificiale, që janë zhurma të forta për valët delikate të ardhura nga galaksitë dhe yjet. Me teleskopët modernë, instrumente me saktësi të pashembullt, sot shihen qindra mijëra galaksi, kur dikur mendohej se gjithçka është në kozmos ndodhej brenda galaksisë sonë (deri të *Rruga e Qumështit*). Po ashtu si spektrografet me saktësi të pakonkurueshme që bëjnë vazhdi-



misht regjistrime të sinjaleve të ardhura nga Universi, i krijuar në një çast fillestar, përmes një procesi të quajtur Big-Bang, ose shpërthimi i madh (shpjegohet ligji Hubble që çon në përfundimin se i gjithë Universi zgjerohet). Autorja shpjegon gjithashtu se si leximi i drejtpërdrejt i Big-Bangut është një nga motivet e studimit të valëve gravitacionale, që janë të lidhura me Teorinë e Përgjithshme të Relativitetit të Ajnshtajnit.

Me një gjuhë të thjeshtë, në libër aktualizohet një bisedë midis dy personazhesh për të shpjeguar teorinë e nobelistit të madh mbi hapësirën dhe rrjedhjen e ndryshme të kohës në sisteme të ndryshme referimi. Teori që solli shumë diskutime dhe pikëpyetje të mëdha edhe për arsyen se ishte mbështetur mbi ekuacione shumë të komplikuar për t'u shkruar e zgjidhur. Po aq interesante është për lexuesin të njihet me shpjegimet e autorës sonë për zbulimet më të fundit që tërhoqën vëmendjen e botës shkencore (në qershor dhe në korrik 2018), zbulime të bëra nga teleskopi i Kilit, për eklipsin e diellit, që konfirmoi teorinë e Ajnshtajnit. Teori që hap shtigje të reja në shkencën moderne të astrofizikës. Për shembull, mbi të mbështetët sot kozmologjia aktuale.

Një shembull tjetër ku shkenca e astronomisë e bërë më e afërt nëpërmjet shpjegimeve dhe aktualizimeve të autorës në libër është historia e krijimit dhe funksionimit të makinës hapësirnore Kepler, “gjahtarës së planetëve”. Vetëm para pak ditësh NASA ka deklaruar jashtë funksionit teleskopin Kepler që ishte hedhur 10 vjet më parë në

hapësirë. Ashtu siç parashikohej dhe siç përshkruhet në këtë libër asaj do t'i shterëj karburanti dhe do të humbte lidhjen me tokën, por se kur nuk dihej. Bota shkencore e gmonë kontributin e paçmuar të teleskopit Kepler sepse bëri zbulimin e 2681 planetëve jashtë sistemit tonë diellor, kur vetëm para një shekulli besohej se universi nuk ndryshon. Edhe ne amatorët e zbulimeve dhe zhvillimeve të reja në univers e kuptuam keqardhjen që ndjenë shkencëtarët për kalimin e tij në kozmos si “trup i lirë”, duke qenë se i kishim njohur mirë vlerat dhe kontributin që dha në kërkim të botëve aliene dhe të ekzoplanetëve, por edhe prej përshkrimit të përpjekjeve të pashembullta që u bënë për ta mbajtur në punë një kohë sa më të gjatë.

Me ndjeshmëri artistike autorja përshkruan keqardhjen e banorëve të Tokës kur panë vendin krejt periferik që zë Toka në foton e marrë nga Voyager 1 ('1990). Atë kohë kur planeti ynë i parë nga miliarda kilometra larg u quajt Pale Blue Dot – Pikë e Kaltër, prej ngjyrës së oqeanëve dhe të qiellit të saj. Tekstet e librit shpesh janë ilustruar me foto, nga të cilat fotoja e Tokës e parë nga Hëna është një nga më tërheqëset, jo vetëm për cilësinë, por edhe se tregon se ç'arritje të papërfytyrueshme kanë bërë misionet për njohjen e Universit!

Spas përshkrimeve në libër ndjekim përpjekjet e shkencëtarëve që tani janë përqendruar për të gjetur qenie të ngjashme me ne si dhe për mundësitë e jetës jashtë Tokës. Për ekzistencën e së cilës në ekzoplanetët duhet 1) të ketë terren shkëmbor dhe temperatura të jetë mes 0 dhe 100C për të pasur ujë që të jetë në gjendje të lëngët. S'është e rastit hedhja në hapësirë e *Diskut të Artë*, ku janë regjistruar të dhëna mbi Tokën tonë dhe banorët e saj, klithma kafshësh e të qara fëmijësh etj. me shpresë që mesazhet e tij të bien në dorë të alienëve. S'e dimë në se do të arrijnë të deshifrojnë këto kumte, por një gjë duket e pamundur që në gjithë këto galaksi të pafundme të mos ketë jetë njerëzore! Po si do të jetë ajo? Me zbulimet fantastike që po ndjekim duket se kjo ëndërr e njerëzimit nuk do të jetë larg së qeni realitet, vërejmë shkencëtarët.

Në këtë rrugë që kanë ndjekur edhe shumë fizikanë të shquar për të popullarizuar zbulimet e bëra në fushën e studimit të Universit ecën dhe studiuesja Hafizi që një pjesë të librit të saj ia kushton përsiatjeve të fantazisë sidomos për ekzistencën e jetës së krijesave aliene dhe marrëdhënieve midis tyre. Nëse dikur në librat fantastiko-shkencorë pjesën më të madhe të krijimtarisë së shkrimtarit e zinte fantazia (“Mjegullnaja e Andromedës”, “Marsi, Planeti i kuq”) në librin e profesoreshës Hafizi fantazia është në funksion të studimeve shkencore. Libri ka një konceptim interesant: në një krah është

R

REVIEW

Eshtë zakon që në shkrimet për librat, të flitet për subjektin, karakteret, të argumentohet se përse ky roman duhet lexuar. Dhe nuk është zakon i keq. Por në rastin e Zija Çelës kjo është e tepërt. Sepse Zija Çela nuk të zhgënjën në asnjërin nga krijimet e tij, qofshin tregime të shkurtër prej disa faqesh, apo romane qindra faqesh. Mjafton të lexosh disa paragrafë për të kuptuar se sa madhështore e magjepsëse është gjuha e shkruar, se çfarë bukurie tronditëse dhe imponuese bart në vetvete fjala, sa urtësi dhe dije universale ruhet në kodet e saj...

NGA LAZËR STANI

Shkrimtari Zija Çela me romanet e tij të njëpasnjëshëm të botuar në këto vite, ngjan me një shkrimtar që e ka zënë gjithë hapësirën e tij krijuese, korpusi i tij letrar ngjan i përplotësuar, ku as mund të shtosh e as mund të heqësh gjë prej gjëje. Megjithatë me Zija Çelën ngjet si me hapësirën që zgjerohet; hapësira e tij krijuese zgjerohet nga romani në roman, sa fundi i romanit të sapobotuar ngjan sikur mbjell farën e një romani të ri. Dhe në këtë hapësirë krijuese që zgjerohet, secili roman pasardhës është më gjithëpërfshirës, më total. I tillë është edhe romani i sapo botuar, "Djali Komik"; një roman total, gjithëpërfshirës.

Milan Kundera në esenë e tij të gjatë "Arti i Romanit" shkruan se "Romani është një meditim për ekzistencën siç shihet ajo nëpërmjet mediumit të karaktereve imagjinare". Zija Çela me imagjinatën e tij magjepsëse dhe me energjinë e tij të pashtershme krijuese pikërisht këtë ka arritur: të shkruajë një roman tronditës për ekzistencën tonë të mbushur me pasiguri, absurd, tragjizëm, ku jetët dhe fatet njerëzore, luhën në një skenë groteske, herë herë qesharake.

Si edhe në romanin e tij të mëparshëm, në procesin e tij krijues, Zija Çela krijon një univers paralel me universin në të cilin jetojmë, një univers që është vetëm i tij, ku shkrimtari gëzon lirinë e tij të pakufizuar nga modelet, traditat, shkollat letrare, imponimet që të bën realiteti mbytës dhe historia me dëshmitë e saj kokëforta, të patjetërueshme. Në këtë univers të tij krijues, paralel me tonin, Zija Çela është i gjithi vetvetja në nivelin më të lartë të shfaqjes, në

Universi paralel i Zija Çelës "Djali Komik", romani më i ri i shkrimtarit



formën më të lartë të ekzistencës, atë të demiuqut, krijuesit.

Kur kam shkruar për romanin paraardhës "Ora e Zooparkut" kam thënë se Zija Çela nuk është një shkrimtar që ne e lexojmë; ai është një shkrimtar që na lexon ne njerëzve, lexuesve të tij. Në romanin e ri "Djali Komik" shkrimtari ndjek një procedurë tjetër: Ai vë në objektivin e syrit të tij shoqërinë shqiptare, por edhe shoqërinë njerëzore në tërësi, ashtu sikurse një mikrobiolog vë në objektivin e mikroskopit një

koloni bakteresh dhe e vëzhgon, e deshifron dhe e përshkruan me një gjuhë drithëruese, ku spikat imagjinata magjepsëse dhe stili mjeshtror i rrëfimit. Kolonia njerëzore në romanin "Djali Komik" është një koloni e vështur me një sy pa perde, me një sy depërtues, që sheh thellë e më thellë në qenien tonë individuale dhe në organizimin tonë social e shtetëror, zbulon raportet ngjethëse të individëve, në të shumtën e herës të degraduara, të molepsuara nga mungesa e idealit, bjerrja e virtytit dhe çthurja, të dekompozuar deri

në një shkallë të frikshme, aq sa të vjen të ulërasësh: këta jemi ne, kjo është shoqëria në të cilën jetojmë, kjo është bota groteske në të cilën ekzistojmë. Universi paralel i Zija Çelës, edhe pse *fiction* i pastër, është në të njëjtën kohë universi ynë tragji-komik, veçse shkrimtari me aftësinë e tij, arrin të na çlirojë disi nga verbëria kolektive.

Eshtë zakon që në shkrimet për librat, të flitet për subjektin, karakteret, të argumentohet se përse ky roman duhet lexuar. Dhe nuk është zakon i keq. Por në rastin e Zija Çelës kjo është e tepërt. Sepse Zija Çela nuk të zhgënjën në asnjërin nga krijimet e tij, qofshin tregime të shkurtër prej disa faqesh, apo romane qindra faqesh. Mjafton të lexosh disa paragrafë për të kuptuar se sa madhështore e magjepsëse është gjuha e shkruar, se çfarë bukurie tronditëse dhe imponuese bart në vetvete fjala, sa urtësi dhe dije universale ruhet në kodet e saj. Fjalët në penën e Zija Çelës jo vetëm krijojnë me perfeksion një univers paralel, por edhe na bëjnë të jetojmë e të ndihemi të shpëtuar brenda këtij universi.

"Romanet janë për njerëzit e tjerë, kurse poezitë shkruhen për vetveten", thoshte poeti amerikan Filip Larkin.

Duke cmontuar gurët e shtëpisë së jetës së tij, Zija Çela, projektionet dhe ndërton krijimet e tij për ne, njerëzit e tjerë, lexuesit e tij, përçka ne i jemi thellësisht mirënjohës.


→ Vizion nga faqja 19

studimi shkencor dhe nga faqja tjetër trillimi artistik mbështetur po mbi faktin shkencor: Psh. nëse ne kemi arritur të kapim një sinjal nga një planet, nisur shumë vite më parë (1948), p.sh. siç është planeti Proxima B që ndodhet në zonën e cila përbush kushet për t'u quajtur "e banueshme" pse të mos fantazojmë për ekzistencën jetës aty? argumenton Hafizi pasi ka arritur të na shpjegojë se si është arritur të zbulohet së fundmi grupi i 7 planetëve, ku Planeti Proksima B, ekzoplaneti më i afërt me ne, rreth 4 vite dritë larg, bën pjesë në vërtitjen e përbashkët rreth yllit Proksima e Centaurit. Në tokë ka mbërritur sinjali i një prej ekzoplanetëve të kësaj galaksie, si një pikë e kuqe, që i ka bërë shkencëtarët ta mbiquajnë Pale Red Dot, *Pika Trëndafil*, emërtim konvencional në ngjashmëri me atë mënyrë që e kanë emërtuar Tokën si *Pika e Kaltër*. Nga të dhënat që janë grumbulluar duket se ky është është një nga më interesantët trupa qiellorë të zbuluar së fundmi, pa dyshim falë mjeteve nga më të perfeksionuarat e shkencës së astronomisë, me të cilin autorja merret gjatë duke i lënë mjaft vend edhe trillimit fantastik. Një planet që mbahet vazhdimisht në vëzhgim për komunikime të mëtejshme, sepse "objektivi kryesor tani është që të zhvillohen teknikat e duhura për një udhëtim të mundshëm drejt një trupi qiellor jashtë sistemit tonë diellor"...

Natyrisht që qendra kërkimore të rëndësishme si NASA, ESO etj., disa universitete amerikane me emër, që kanë nxjerrë me dhjetëra nobelistë, aktivitetin e të cilëve duket se autorja e njeh mirë, janë jo vetëm nxitësit, por edhe realizuesit e një pune të madhe kërkimore shkencore në lëmin e astrofizikës, ndër të cilët shumë janë të rinj. Të bëjnë përshtypje konstatimet e autores për punën

Një libër sui generis i Mimoza Hafizit - "Pika Trëndafil – Për ne dhe alienët"

(Roman shkencor)



kërkimore shkencore në universitetet amerikane ku liria dhe hapësira krijuese mbështeten mbi motivin prioritar që e afishojnë: "e vërteta do t'ju bëjë të lirë". Çka e bën autoren të japë mendime, dhe përsiatje filozofike mbi njeriun si qenie biologjike dhe shoqërore, duke vlerësuar veçanërisht

marrëdhëniet korrekte në shoqëri si arritje të kulturës njerëzore krahas arritjeve të mëdha shkencore.

Në libër i vihet rëndësi faktit se interesi për zbulimet e reja në astronomi është bërë pjesë aktive një brezi të ri të pasionuarish edhe pa qenë shkencëtarë të mirëfilltë. Midis të tjerash duket dhe dëshira e shkencëtarëve, autores së librit që tenton të grishë edhe të rinjtë shqiptarë, ose njerëz të dhënë mbas zbulimeve në Univers që t'i bashkëngjiten interesimit global në rritje për këtë fushë që vjen duke ecur me hapa që s'janë parë deri më sot.

Nuk ka aspak fantazi pa baza, por përkundraz; prandaj libri është interesant. Për më tepër në përplekjet për të dhënë një përfytyrim sa më të saktë të teorive shkencore që trajtohen në libër autorja e ka pajisur atë me një informacion shkencor (të vendosur në fund të librit) si dhe me foto të marra nga zbulimet e misionëve hapësinore ose të përpilura nga ajo vetë, me diagrame, skica edhe tabela për ta bërë sa më të kaphshëm materialin shkencor. Bie në sy se ilustrimet janë të një niveli mjaft më të mirë nga ana poligrafike në krahasim me ilustrimet që gjen rëndom në librat tanë. Për të ruajtur

vërtetësinë dhe autorësinë e tyre si dhe për të ndjekur më tej ndonjë aspekt të çështjes që trajton, shpeshherë autorja ka vënë adresat e sajeteve në internet, ku të interesuarit mund vërtetojnë autenticitetin ose të zgjerojnë njohjen.

Një vërejtje do të kisha për redaktorët që kanë kaluar materialin para botimit. Retrospektivat në tekstin artistik, sidomos në pjesët kur kalohet nga e tashmja të shkruarën mund të ishin paraqitur grafikisht ndryshe, jo vetëm me hapësirë dhe ritencë. Për shembull teksti që bën fjalë për të kaluarën mund të ishte paraqitur me një tjetër lloj shkronje, që ideja e autores dhe vendosja në kohë të ishte e kaphshme më shpejt nga lexuesi. Për sa i përket materialit artistik ai duhej punuar më mirë nga ana kompozicionale dhe e karaktereve që të merrte vërtet formën e një romani. Por kjo mungesë kalon në plan të dytë, kur konstatohet se peshën kryesore të tekstit e mban trajtimi shkencor, vrojtimet shumë interesante nga zbulimet, përplekjet e pashtershme e plot kuratë të njeriut për njohjen e Universit, që engrenë cilësinë e librit duke i dhënë vlera të padiskutueshme dhe bërë tërheqës për cilindo lexues.

Dje në "European Interest"

Shqipëria drejt BE-së, një rrugëtim i shpresës dhe i sfidave

Nga Monika Kryemadhi

(vijon nga faqja 1)

... por me një besnikëri të madhe ndaj një partneri strategjik siç është BE, edhe pse mes shumë sakrificash, përpjekjesh dhe sfidash për t'u përafuar me vlerat dhe trajektoren europiane.

Që prej vitit 2014, Shqipëria gëzon statusin e vendit kandidat, por rrugëtimi i saj që prej atij viti është ngadalësuar shumë. Sot përballlemi me një proces të paparashikueshëm, pa një kalendër të qartë hapash, që e bëjnë gjithmonë e më të paprekshme perspektivën tonë europiane.

Fenomenet e kohëve të fundit me të cilat është ndeshur BE si Brexit, flukset migratore dhe terrorizmi e kanë zbehur gjithmonë e më shumë politikën e zgjerimit, duke e spostuar atë në radhët e axhendës prioritare. BE çdo ditë e më shumë ndjen nevojën e jash-tëzakonshme për një reformim të thellë strukturor. Nevoja për të forcuar unitetin mes 27 vendeve anëtare tanimë është më emergjente se sa imbakimi i vendeve të reja aspirante, që shpesh mbartin me vete problematika shtesë për vetë BE.

Shqipëria është pjesë e këtij udhëkryqi, ku nevoja për mbështetje nga BE është ulëritëse.

Problemi më i madh mbetet në politikën e brendshme.

Shqipëria është një vend me institucione të dobëta, me shoqëri civile gati jo ekzistente dhe me një kulturë politike, ku shteti është i kapur në të gjitha nivelet nga një individ i vetëm.

Një vend ku liderët mendojnë më shumë për marrje pushteti, se sa për shpërndarje të pushtetit dhe për ndërtim të një shteti të drejtë për qytetarët e saj. Reformat janë përdorur më së shumti për populizëm sesa për standarde dhe ndaj, sfida jonë nuk është thjesht fitimi i zgjedhjeve, por shtrimi i themelit të demokracisë.

Kanë kaluar më shumë se 2 vite nga fillimi i implementimit të Reformës në Drejtësi dhe sot po përballlemi me një koncept totalitar të kapjes së shtetit në të gjitha hallkat e tij. Rrezik edhe më të madh përben fenomenin i konstatuar nga vetë Komisioni Europian në Strategjinë e Zgjerimit, ai i lidhjes së politikës me botën e krimi. Fatkeqësisht ky i fundit ka penetruar në qeverisje dhe deri në ekonomi, duke rrezikuar Sigurinë Kombëtare, por edhe atë europiane.

Ekonomia e vendit është krejtësisht nën kontrollin e pak grupeve oligarkike, të lidhur me kryeministrin.

Shpenzimet publike realizohen ekskluzivisht nga këto grupe. Qeveria ka iniciuar programin i Partneritetit Publik-Privat, pa



varësisht kundërshtimeve të forta prej disa institucioneve ndërkombëtare si FMN. Nëpërmjet procedurave jotransparente, realizohet pa konkurrim prokurimi i veprave publike, me fatura të jash-tëzakonshme detyrimesh vjetore nga buxheti i shtetit ndaj privatit, me burime financimi të dyshimta, me kosto të disafishta të punimeve, që rrisin kështu detyrimet buxhetore (borxhin publik) ndaj tyre në vitet e ardhshme. Opozita dhe institucione të pavarura kanë akuzuar kryeministrin për përdorimin e këtyre skemave për pastrimin e parave të krijuara nga lulëzimi i ekonomisë së drogës kanabis nën këtë mazhorancë.

Kjo skemë korruptive dhe pastrimi i parave i lidhur me të, ka shkatërruar edhe listën e prioritetive të energjisë dhe infrastrukturës si detyrim i vendit ndaj Hartës së Samiit të Vjenës, në kuadër të Procesit të Berlinit.

Ndërkohë, politikat ekonomike kanë dështuar të rrisin eksportet e vendit (ndër më të ulëtat në rajon në raportin eksporte/PPB), të rrisin konkurrueshmërinë e ekonomisë dhe të forcojnë besimin e biznesit dhe konsumatorit. Për të mos folur për mungesën e vizionit strategjik në prioritetet zhvillimore të vendit, reflektuar në ndryshime të shpeshta fiskale dhe metoda "quick fix" në mbështetjen e sektorëve prioritarë.

Në kemi nevojë për liderë me

vizion dhe bashkëpunues, që do t'i japin mundësi vendit të pozicionohet qartë në perspektivën euroatlantike, por njëkohësisht të ruaj marrëdhënie të mira me fqinjët dhe të dijë të peshojë aktorët e rëndësishëm global, siç është dhe Kina.

Në fund të fundit rrugëtimi i integritit të Shqipërisë në BE është i lidhur ngushtë me zhvillimin tonë ekonomik, me standardin e jetës së qytetarëve tanë. Marrëdhëniet mes Shqipërisë, BE dhe Kinës nuk kanë pse të jenë kush-tëzues dhe as përjashtues ndaj njëra-tjetrës. Axhenda jonë e integritit evropian nuk pengohet dhe as mbivendoset me intensifikimin e bashkëpunimit ekonomik me Kinën. Përkundrazi, financimi i projekteve strategjike me impakt direkt në ndërlidhjen e infrastrukturës rajonale me tregun evropian është në interesin jo vetëm të zhvillimit të shpejtë ekonomik të rajonit, por edhe të vetë BE-së në raport me axhendën dhe ambicën e saj të zgjerimit.

Vetë BE është munduar të forcojë konceptin e stabilitetit dhe mirëqeverisjes në vendet si Shqipëria. Fatkeqësisht, deri më tani kjo alternativë ka dështuar. Rautja e status-quo nuk e ka ndihmuar rrugëtimin e Shqipërisë drejt BE, madje ka shkaktuar një destabilizim të brendshëm, duke rikthyer tiparet diktatoriale dhe duke i polarizuar palët politike me shumë së kurrë.

Ajo çka Bruskeli ka harruar

është se në vendin tonë stabiliteti vjen vetëm nëpërmjet forcimit të demokracisë dhe shtetit të së drejtës. Ndaj vendosja e theksit të rëndësia e institucioneve dhe jo tek individi është tashmë jetike për ne.

Dhe së fundmi, por jo për nga rëndësia, çelja e negociatave të Shqipërisë me BE është një katalizator për ecurinë e reformave, një proces që mbart vlera të mëdha në vetvete. Ky është i vetmi proces që mund ta vendosë Shqipërinë në kornizën e rregullave dhe standardeve si dhe nën monitorim të rreptë nga vetë BE, nga e cila përfitojnë më shumti qytetarët shqiptarë.

Një shoqëri e rraskapitur nga pritja për ta parë Shqipërinë si gjithë Europa dhe nga zhgënjimi i politikës dhe qeverisjes aktuale, që humbet rrinë dhe të ardhmen, që po largohet çdo ditë e më shumë nga vendi për të rigjetur shpresën në vendet e zhvilluara të BE. Negociatat janë e vetmja etapë që mund t'i japë fund arrogancës qeverisëse.

Shqipëria ka nevojë për një dritë jeshile dhe për një proces strikt të bazuar mbi meritë, jo vetëm për të pasur rezultate konkrete, por në të njëjtën kohë për rolin nxitës të vetë bisedimeve për anëtarësim!

*** Editorial për - "European Interest" titulli original. "Albania toWards the EU - A Journey of hope and challenges"**

HOROSKOPI

DASHI

Shmangni fantazitë, sepse mund të përballeni me zhgënjime të mëdha. Më mirë qëndroni me këmbë në tokë. Financat do jenë në një gjendje të qëndrueshme. Beqarët do kenë ndryshime të thella në jetën sentimentale.

DEMI

Financat do të kenë përmirësime falë mënyrës suaj të kursimit. Dëshira për të qëndruar sa më shumë me partnerin dhe për të përjetuar emocione do jetë e zjarrtë gjatë kësaj dite. Në punë mund të merrni një propozim.

BINJAKET

Ditë jo me shumë mundësi sa u përket çështjeve emocionale. Në planin financiar çdo gjë do shkojë për mrekulli. Për ata që janë të papunë, mundësi të reja duken në sfond, që duhen kapur në kohë.

GAFORJA

Mos u lodhni duke kërkuar princin e kaltër. Yjet do ju favorizojnë në dashuri. Ditë e mirë për projekte të rëndësishme financiare. Investimet do të rezultojnë të suksesshme falë mendjes suaj brilante.

LUANI

Një ditë e mirë për ta lëshuar pak dorën sa u përket shpenzimeve. Mund të blini ato gjëra që i keni pasur në mendje prej kohësh. Financat tuaja nuk do të dëmtohen aspak për shkak të këtyre blerjeve.

VIRGJERESHA

Në aspektin e ekonomisë do ju duhet të hiqni dorë nga disa shpenzime. Ambianti në jetën tuaj në çift do jetë shumë i qetë sot. Përfitoni për të folur mbi disa çështje dikur të vështira dhe për t'i zgjidhur ato njëherë e mirë.

PESHORJA

Në çështjet ekonomike duhet të merrni mirë parë se të kryeni çdo lloj shpenzimi. Pas një periudhe jo shumë të qetë në dashuri, sot do rikthehen shpresa. Beqarët kanë shumë mundësi të gjejnë partnerin.

AKREPI

Në planin financiar duhet të tregoheni të kujdesshëm me çdo hap që hidhni. Me partnerin do të keni mendime krejtësisht të kundërta mbi një temë të rëndësishme, por edhe mbi të ardhmen.

SHIGJETARI

Në aspektin financiar nuk duhet absolutisht të tregoheni impulsivë, sepse do përballeni me probleme serioze. Beqarët nuk do e ndiejnë shumë mungesën e dikujt në krah, sepse miqtë nuk do i lënë për asnjë çast vetëm.

BRICJAPI

Në vendin e punës mund të hasni disa pengesa artificiale. Me shumë zgjuarsi do të dini si t'i kaloni vështirësitë. Në planin financiar nuk do të keni asnjë vështirësi të pakapërcyeshme.

UJORI

Do të merrni lajme të mira në punë. Falë angazhimit tuaj, mund të merrni rritje roge ose rritje në detyrë. Për pjesën më të madhe të atyre që janë në një lidhje dashurore, dita do jetë bukur dhe pa probleme.

PESHQIT

Do të jetë një ditë me fat në planin romantik. Nëse nuk jeni në një lidhje, gjasat janë që të mund të gjeni partnerin. Në planin financiar situata do jetë e stabilizuar, pa shumë ulje-ngritje.

Opinion

Sportiv

Pse Rama dhe Basha janë "të ashpër" me ndërkombëtarët

Nga Ben Andoni

(vijon nga faqja 1)

... duket se janë në një "ishull", ku e gjithë linja e komunikimit diplomatik, përmes notave, urdhërave, këshillave dhe sugjerimeve është periferike. Paçka ngarkesës që mendohej t'i japim ne, diplomatët e huaj janë pa ndonjë peshë të madhe sa i përket ndikimit të rregullimit të marrëdhënieve të Shqipërisë me vendet e tyre respektive. Përveç vendeve fqinje dhe ndoshta pak vendeve të tjera, që kanë interesa të ngushta me vendin tonë, të paktën, nga reagimi i zyrtarëve të lartë (eporëve të tyre) ose kumteve të tyre kupton, që puna e diplomacive të tyre në Tiranë është pothuaj e pavërejtshme. Pa e hedhur poshtë punën dhe kontributin e tyre, një njeri i thjeshtë kupton se mbivlerësimi i shqiptarëve për këto institucione është pak si shumë qesharak. Që do të thotë se shqiptarët për çdo hall mendojnë se vetëm ambasada amerikane mund ta zgjidhë dhe pak të tjerat, por në fakt e vërteta është e thjeshtë. Ne jemi një vend periferik dhe në skaj të gjërave, pa ndonjë rëndësi të madhe në skakierën ndërkombëtare.

Ambasadat e huaja janë të lokalizuara në vende të tjera përfaqësimi për të siguruar imunitet diplomatik dhe për të përfaqësuar



interesat e vendit të tyre, si edhe për të siguruar lidhjen me qeverinë e vendit të tyre për probleme të ndryshme dhe qytetarët e tyre. Kjo është arsyeja, që kur priten trazira në vend, ambasadat para se t'u bëjnë sugjerime zyrtarëve të vendit pritës, u drejtohen në mënyrë shumë rigorozë qytetarëve të tyre për të pasur kujdes. Më shumë akoma, çdo ambasadë në një farë mënyre është pronë e

kombit që përfaqëson. E vetmja gjë e shenjtë që lidhet me të është se çdokush atje nuk mund të preket nga autoritetet, pasi vendi ku ajo është e akredituar nuk mund të cenohet. Irani e provoi kundër SHBA-ve, apo kur përfaqësia kanadeze ishte larguar duke merituar urretjen e gjithë publikut. Por, regjimi komunist nuk guxoi të urdhëronte që të futeshin në ambasadën italiane,

kur u strehua familja Popa, ashtu si Hitleri as nuk e provoi preken e ambasadave të huaja, duke u mjaftuar me çmendurinë e tij fatale.

Më idenë tonë: Neutraliteti, ambiguiteti i deklaratave të ambasadoreve, inkurajimi i personazheve të përfolur e ka treguar më së miri këtë ide. Veçse kur pushteti i Berishës kaloi çdo parametër normal, ai mori mesazhe të qarta nga am-

basadat e vendeve aleate të kish-te kujdes, ashtu si shpesh e më shumë indirekt këto mesazhe po i drejtohen direkt zotit Rama. I vetmi që nuk e ka provuar deri tani, në këtë nivel, por që me siguri do ta provojë mund të jetë z. Basha.

Janë përpjekje të pafundme për investime në vend që janë penguar dhe pengohen nga politikanët apo sugjerime të ambasadave për biznese që nuk janë marrë parasysh ose janë marrë ato që s'kanë qenë aq shumë rentabël, saqë e ka ulur realisht vlerën e diplomacisë së huaj në vendin tonë. Ku që prej 100 viteve, diplomati i huaj, goftë dhe më i parëndësishmi shikohet si guvernator i Shqipërisë.

Kjo e ka bërë kryeministrin Rama dhe më së fundmi edhe Lulzim Bashën që të jenë të neveritur dhe të egër me të huajt. Tek e fundit kanë kuptuar se mënyra sesi i kanë përdorur të huajt dhe reagimi i këtyre të fundit, kur s'janë bërë lojë e tyre, është e hidhur. Në këtë botë të gjithë përdoren, por veçse përdorimi i diplomatëve ka kosto shumë të lartë. E para, sepse duhet të kthesh ndere dhe e dyta, sepse duhet të mbash premtime. Për të dyja, zyrtarët shqiptarë kanë treguar se nuk janë aq të ndershëm. Kjo të vjen ndërmend, kur për 100 vjet me radhë sillemi me një mentalitet sikur jemi ende koloni dhe jo shtet sovran dhe i pavarur. (Homo Albanicus)

THASHETHEME MADE IN ALBANIA

BLUE TOOTH

THASHETHEME MADE IN ALBANIA

Te gjitha te rejat nga jeta ipave

GAZETA SHQIPTARE

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

1. Eshhtë babëzia.
8. Burton regjisor.
11. Skllavja e Abrahamit.
12. Një dite në mbledhje.
14. Tyson i boksit.
15. Rrethojnë ringun.
17. Beson pa kufij.
19. Zola që shkroi Nana.
20. Eshhtë ankimum.
23. Pak elementare.
24. Janë me para në bankë.
26. Matet pa kufij.
27. Janë ngrehina për reparte fabrikash.
28. Një zog i verdhë.
29. Inicialet e Moravia-s.
31. Qytet gjerman.
34. Një zonjë që ha gurë.
35. Pak analogji.
36. I ka plasur të paturpit.
37. Janë legjendat.

38. Nuk ka akoma një bebe.
39. Fillojnë mirë.
40. Janë brinjë në skuadër.
42. Shkruhet i shtati.
44. Nget edhe ajo e mirë
47. Mbahet në gisht.
48. Janë numrat 1, 3, 3...

VERTIKAL

1. Kanë shpatë të tilla.
2. Janë edhe ato polare.
3. Janë mizorët.
4. Janë male në Rusi të tilla
5. Eshhtë nusja me vello.
6. Një rreth pa ekstreme.
7. Mbyllin kuvendin.
8. Në kryt të titujve
9. Diku në qendër.
10. Markë cigaresh.
13. Janë rrëfimet e të pandehurit.
14. Janë penjtë për gjergjef.
16. Mbarojnë fare.
18. Janë stitët e... provimëve.
20. Mund të jenë fotografikë të tillë.
21. Vitet pa kufij.
22. Një fjalë për tutje.
24. Brown i Kodi i Da Vinci-t.
25. Eshhtë e akuzuara... injorante
26. Baldwin aktor
27. Një pjesë e kandidatëve.
28. Krenar pa gift.
30. Grazia Cucinotta.
32. Paul këngëtar.
33. Janë pëshjtellat.
35. Inicialet e Moravia-s.
37. Pak makinacione.
38. Samuel bomber kamerunas.
40. Markë makine koreane.
41. Ente Kombëtare Durrës.
42. Fillojnë kurat.
43. Inicialet e Zemeckis regjisor.
45. Ekstreme në litat.
46. Fillojnë lejen.

Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL

1. Satelit i Uranit.
6. Eshhtë edhe ai i Pallës.
11. Tiran pa kufij
12. Në krye të armatës.
13. Një Ibrahim violinist.
14. Qendër ditore.
15. Mund të jenë fotografikë.
17. Inicialet e Einstein.
18. Një mbishkrim në kryq.
20. Janë si vite.
21. Thurman aktore.
22. Të parat në irritim.
23. I preu Seneka.
25. Fillojnë iustrimet
26. Isaac Asimov.
27. Një Vladimir kompozitor.
28. Janë në modë.
30. Janë zyrat... qeveritare
32. Me të nxjerrin trarë.
35. Një shkop, thupër.

VERTIKAL


37. Eshhtë Shqipëria e madhe.
39. U thyen në Salamina.
40. Një raport shumë i ngushtë.
41. Nota e diapzonit.
42. Fund heroi.
43. Një top në rrjetë.
45. Gjysma alarmi.
46. Herët pa zë.
47. Sampras i tenisit.
48. Me to bëjnë triko.
49. Një guajtje fluturimthi në tenis.
50. Janë kokrrat e listit.

VERTIKAL


1. I famshëm ai i Sizifit.
2. Mund të jetë e hollë dhe therëse.
3. Fillojnë rastësisht.
4. Një pjesë e napolitanëve.
5. Janë situatat e rrezikshme para portave.
6. Mund të jenë kundërajrore.
7. Lindin në kokë.
8. Gjysmë shtegu.
9. Hiden të parat.
10. Eshhtë njeriu i përsosur.
13. Një fjalë për tutje.
15. Fundi i një samurai.
16. Mbyllin me epilog.
17. Bel i maupassant.
19. Inicialet e Redford.
23. I manifeston nxënësi i papërgatitur.
24. Në hyrje të tokës.
26. Pak impresioniste.
27. Janë metrat në sipërfaqe
29. Hapat një për ajër.
30. Gjysmë krenar.
31. Një hidrokarbur.
33. Vrau Hektorin.
34. Një film i rixhiruar.
36. Kupat pa kufij.
38. Inicialet e Nolte aktore.
41. Ullimann aktore.
43. Një brilantë moderne
44. Hotel pa kufij.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

7		5	2	4		9	8	
					1		2	
4		2		5		3		
2						8	7	5
					2	1		
1	9	8		6		2		
	6		3					
						7	3	
7	3	8						

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

1	9	7	8	2	6	5	4	3
3	8	4	5	1	9	7	2	6
6	2	5	4	3	7	1	8	9
2	3	1	7	6	8	4	9	5
7	4	6	2	9	5	8	3	1
9	5	8	3	4	1	2	6	7
5	6	9	1	8	2	3	7	4
4	1	2	9	7	3	6	5	8
8	7	3	6	5	4	9	1	2

Argëtim filozofik

- Njerëzit ndryshojnë nga njëri-tjetri nga koka, jo nga këmbët
- Miqësia është si drita e shkrepëtimit; sa më i errët të jetë vendi, aq më shumë ndriçon.
- Rruga e jetës është drejtësia, mos u ndaj nga rruga për të hyrë nëpër rrugica.
- Njeriu mentar nuk flet për veten e tij dhe për punë që i përkasin atij vetë.
- Kush ve interesat e përgjithshme mbi të tija, është njeri me të vërtetë.

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

1	K	U	7	L	2	T	14	4		9		7	4	19	M	A	S	H	U	R	K	A		I	R	A	K	
8	10	5					1	4	12	2	6	7	5	10	E	S	T	E	R	A		D	H	U	N	A		
10	4	7					4	1	2	9	10	6	4	7	5	I	T	E	A	T	E	R		M	I	N		
18							1	7	5	8	9	4	2	10	4	E	R	A		P	O	L	A	R		T	A	
6	5	1					6	2	10	5	2	5		12	K	E	L		P	O	L	E	M	I	K	A	T	
7	1						17	5		1	5	10	17	4	2	L		P	O	L	I	G	A	M	I			
2	5	10	17	4	2				4	10	6	6	15	5	E	T	A		P	I	K	A	T		R	E	L	
8		2	8	12					15	6	10	17	5		K	O	M	O		D	E	N	T	O	K	E		
18	10	5	16	19					6	4	8		10	1	T	R	I		S	E	T	M		N	U	N		
6		7	5						6	11	5		9	19	6	7	I	T		T	U	T	U		I	T	I	D
4	11	4	7	6	2	6	1	5			7	17	6		K	A	D	E	T		K	O	S	H		L	E	
12	5	2	5						12	1	6	15	4	2	8	E	T	I	K		S	E	K	S	E	R	E	T

PËRGJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

1. BABËZIA
8. BURTON
11. SKLLAVI
12. MBLEDHJE
14. TYSON
15. RINGU
17. BESON
19. NANA
20. ANKIMUM
23. ELEMENTARE
24. BANKË
26. MATET
27. REPARTET
28. ZOGU
29. MORAVIA
31. GJERMANIA
34. GURË
35. ANALOGJI
36. PATURPIT
37. LEGJENDAT

FJALËKRYQI (2)

1. URANI
6. PALLË
11. TIRAN
12. ARMATË
13. IBRAHIM
14. DITË
15. FOTOGRAFI
17. EINSTEIN
18. KRYQ
20. VITET
21. THURMAN
22. IRITIMI
23. SENEKA
25. IUSTRIJA
26. ASIMOV
27. VLADIMIR
28. MODË
30. QEVERITARI
32. TRARË
35. THUPËR

FJALËKRYQI (2)

37. SHQIPËRIA
39. SALAMINA
40. NGUSHTË
41. DIAPZONI
42. FUNDI
43. RRJETË
45. ALARMI
46. ZËRI
47. TENISI
48. TRIKO
49. TENISISTË
50. LISTI

Thënie të mençura

- Jeta e njeriut është një pë i dredhur nga lumturia dhe fatkeqësia. Po të ishte dredhur vetëm nga fatkeqësia, do të ishte këputur shpejt, po të ishte përbërë vetëm nga lumturia, do të ishte tepër i ashpër dhe nuk do të hynte në punë.
- -Gabimi i atij që punon me dëshirë dhe ende, është më i mirë se të qëlluarit e atij që punon pa dashur.
- -Grada e qytetërisë dhe e moralit të një populli kuqtohet nga këngët dhe lojërat e tij.
- -E vërteta është një lloj ujë i nxehtë që del nga toka, i cili shkrin dëborërat dhe akujt që ka përqark, i bën për vetë dhe shtohet duke shkuar dhe sado që mund të ngrihet duke u ftohur ajri.
- pa kaluar shumë kohë prapë bëhet siç ka qenë (ujë irredhshëm).

